



Anti KORRUPSION

ORGAN I SHOQATËS SË AVOKATËVE ANTIKORRUPSION SHQIPTARË



E përdyjavshme, informuese, denoncuese dhe investigative Viti i II botimit Numri 1 14 Korrik 2014 Çmimi 20 lekë (0.5 Euro)
 Adresa: Rruga: "Ibrahim Rugova", Kompleksi "Green Park", Pallati Nr. 26 Cel.: +355 6920 20 512/612 Web: www.antikorruption.com

Korrupsioni në Gjyqësor! Agim Bendo më i korruptuari prej 20 vitesh, gati batanijet e burgut



editorial

Amnisti për hashashin

Para Ligjit të gjithë të barabartë, si Lazarati i Gjirokastrës, i Shkodrës, ashtu edhe për përdoruesit e dozave të vogla, që kanë mbushur burgjet

Nga Av. Ndue Pjetra

Sot në vendin tonë kemi një bum arrestimesh për veprën penale të Prodhimit, Trafikimit, Kultivimit dhe Shitjes të lëndëve Narkotike dhe të gjitha gjykatat e vendit janë në dilemë dhe prandaj lind pyetja për gjyqtarët, se si duhet të veprojnë përse i përket dënimeve. Aktualisht masat e dënimit janë të parashikuara në Kodin Penal, por sipas ngjarjeve të fundit nuk janë të parashikuara për të gjithë shqipëtarët njësoj. Në masat e dënimeve nuk është parashikuar lloji dhe sasia e lëndës Narkotike përse i përket dënimit por është enjëjtë si për Kanabis sativa hashash dhe drogat e tjera si për shembull, Kokaina, ose Heroina. Aktualisht në gjykatën e Tiranës po gjykohej shumë persona që po dënohen për 3, 10, apo 25, gram dhe dënimet e tyre parashikohen minimumi 5 vite burgim.

Faqe 6

drejtësi

Ja pse u krijua Shoqata e Avokatëve Antikorruption

Faqe 4

investigim

Bankat hajdute, ja si po grabisin xhepat e qytetarëve

Faqe 5

denoncim

Kallëzim ndaj AKKP, po abuzon me pronat e shqiptarëve

Faqe 6

botimet

Avokati, njeriu i ligjit që përfaqëson dhe mbron të drejtën

Faqe 8

propozimi

Ndryshimet për dëmshpërblimin e të dëmtuarëve

Faqe 9



Zbardhet radioskopia e plotë e gjyqit që synon t'i marrë pronën pronarit në mënyrë të kundraligjshme

Agim Bendo, gati batanijen e burgut

Gjyqtari që akuzohet për shkelje flagrante me vendimet për pronat

Opinion i brendshëm shqiptar ka konstatuar se në gjykatat tona po rriten çdo ditë mamuthët e korrupsionit, ndërsa BE ka ngritur alarmin, duke konstatuar se vendin e parë për moszbatimin e kërkesave ligjore e mbajnë gjykatat, të cilat janë përfshirë në veprime korruptive të turpshme dhe shumë të rrezikshme për ekzistencën e një shteti ligjor dhe të një shoqërie demokratike. Por deri tani askush nuk ka folur me emër dhe me fakte. Shkeljet ligjore janë të evidentuara në vendimet gjyqësore dhe Shoqata e Avokatëve Antikorrupsion do t'i zbardhë ato rast pas rasti. Në mënyrë që problemet të mos shtrihen në përgjithësi, por që anti-

ligjit t'i vihet emër. Dhe që gjyqtarët që kanë shkelur ligjet të përgjigjen. Në këtë rast kemi analizuar një vendim gjyqësor të gjyqtarit Agim Bendo, i cili bie ndesh me detyrimet e gjyqtarit për të dhënë drejtësi. Por në ditët vijuese do të bëjmë radioskopinë e plotë të vendimeve të këtij gjyqtari dhe të gjithë gjyqtarëve të tjerë për të konkretizuar se çfarë ndodh në gjykatat tona. Shkeljet ligjore të bëra nga gjyqtari Bendo janë shumë të rënda dhe çdo sistem gjyqësor do ta çonte atë më bankon e të akuzuarve për spekulime dhe mosdhënie të drejtësisë, në bazë të ligjit.

Konventa Europiane për të Drejtat e Njeriut

Para se të flasim konkretisht për atë që ka ndodhur me vendimin e paligjshëm gjyqësor të gjyqtarit Agim Bendo po nënvizojmë se aktet dhe dokumentet e tjera në bazë dhe për zbatim të mëtejshëm të saj, përfaqëson një Akt dokumentar të përmasave të mëdha, në kuptim të konkretizimit dhe afirmimit të gjithanshëm të dinjitetit të njeriut, të lirive dhe të drejtave të tij themelore, si një element bazë për një shtet juridik. Sipas së Konventës Europiane të të Drejtave të Njeriut, protokollet e së cilës miratuar rrjedhimisht nga viti 1921 shtator 1970, 20 dhjetor 1971, 1 janar 1990, 1 tetor 1994, deri në 1 nëntor 1998, arrihet në një përfundim themelor, **se e drejta e pronësisë së individit** apo e një kolektivi individësh, si një e drejtë për të poseduar, për të gëzuar dhe disponuar pasurinë e tij, është një e drejtë universal dhe e pacënueshme, në kuptimin që individi apo kolektivi i individëve, ka pushtetin absolut mbi pronën e tij. Por nga ana tjetër, kemi edhe kufizimet e përcaktuara me ligj. Me fjalë të tjera, këto kufizime konsistojnë në përcaktimin me ligj të rasteve, kur mund të ndërhyhet mbi të drejtat e pronarit, nga ana e të tretëve dhe në mënyrë të veçantë nga ana e shtetit, si subjekt i veçantë. Sidoqoftë në të gjithë këto raste, ndërhyrja duhet të bëhet vetëm në dobi publike dhe kurdoherë kundrejt një shpërblimi të plotë dhe të drejtë. Nga rasti që do të analizojmë duket qartë se gjyqtari Agim Bendo i ka shkelur ato në mënyrë flagrante. Në Protokollin Nr.1 të Konventës Për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore, nënshkruar më 15 mars 1952 dhe hyrë në fuqi më 18 maj 1954, thuhet: "Çdo person fizik dhe juridik ka të drejtë për respektimin e pasurisë së tij. Askush nuk mund të privohet nga pronat e tij, veçse me arsye të dobisë publike dhe në kushtet e parashikuara nga ligji dhe nga parimet e përgjithshme të së drejtës ndërkombëtare".



Në zbatim të këtyre konstatimeve të rëndësishme Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë në nenet vijuese sanksionon:

NENI 41.

1. E drejta e pronës private është e garantuar.
2. Prona fitohet me dhurim, me trashëgimi, me blerje dhe me çdo mënyrë tjetër klasike të parashikuar në Kodin Civil.
3. Ligji mund të parashikojë shpronësime ose kufizime në ushtrimin e së drejtës së pronës vetëm për interesa publikë.
4. Shpronësimet ose ato kufizime të së drejtës së pronës që barazohen me shpronësimin, lejohen vetëm përkundrejt një shpërblimi të drejtë.
5. Për mosmarrëveshjet lidhur me masën e shpërblimit mund të bëhet ankim në gjykatë.

NENI 42

1. Liria, pronat dhe të drejtat e njohura me Kushtetutë dhe me ligj nuk mund të cenohen pa një proces të rregullt ligjor.
2. Kushdo, për mbrojtjen e të drejtave, të lirive dhe të interesave të tij kushtetues dhe ligjorë, ose në rastin e akuzave të ngritura kundër tij, ka të drejtën e një gjykimi të drejtë dhe publik brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme e caktuar me ligj.

NENI 145

1. Gjyqtarët janë të pavarur dhe u nënshtrohen vetëm Kushtetutës dhe ligjeve.

NENI 17

1. Kufizime të të drejtave dhe lirive të parashikuara në këtë Kushtetutë mund të vendosen vetëm me ligj për një interes publik ose për mbrojtjen e të drejtave të të tjerëve. Kufizimi duhet të jetë në përpjesëtim me gjendjen që ka diktuar atë.
2. Këto kufizime nuk mund të cenojnë thelbin e lirive dhe të të drejtave dhe në asnjë rast nuk mund të tejkalojnë kufizimet e parashikuara në Konventën Europiane për të Drejtat e Njeriut.

NENI 18

1. Të gjithë janë të barabartë përpara ligjit.

2. Askush nuk mund të diskriminohet padrejtësisht për shkaqe të tilla si gjinia, raca, feja, etnia, gjuha, bindjet politike, fetare a filozofike, gjendja ekonomike, arsimore, sociale ose përkatësia prindërore.

3. Askush nuk mund të diskriminohet për shkaqet e përmendura në paragrafin 2, nëse nuk ekziston një përligjje e arsyeshme dhe objektive.

NENI 15

1. Te drejtat dhe liritë themelore të njeriut janë të pandashme, të patjetërsueshme e të padhunueshme dhe qëndrojnë në themel të të gjithë rendit juridik.

2. Organet e pushtetit publik, në përbushje të detyrave të tyre, duhet të respektojnë të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, si dhe të kontribuojnë në realizimin e tyre. Ndërsa në bazë dhe zbatim të Kushtetutës dhe të Akteve ndërkombëtare në nenet që vijojnë të Kodit Civil gjen një rregullim të posaçëm pronësia dhe konkretisht:

Përmbajtja e pronësisë

Neni 149

Pronësia është e drejta për të gëzuar dhe disponuar lirisht sendet, brenda kufijve të caktuar nga ligji.

Kalimi i pronësisë

Neni 162

E drejta e pronësisë dhe të drejta të tjera mbi sendet janë të transferueshme, përveç kur ndalohet nga ligji ose nga vetë natyra e së drejtës.

Mënyra e fitimit të pronësisë

Neni 163

Pronësia fitohet nëpërmjet mënyrave të caktuara në këtë Kod dhe mënyrave të tjera të caktuara me ligj të veçantë. Veç këtyre dhe një sërë Dispozitash ligjore të veçantë rregullojnë të drejtën e pronësisë në Republikën e Shqipërisë.

KUSHTETUTA

Siç jemi në dijeni nga BE konstatohet se vendin e parë për moszbatimin e këtyre kërkesave të përshkruar më sipër e mbajnë gjykatat, të cilat janë përfshirë në veprimet korruptive të turpshme dhe shumë të rezikshme për ekzistencën e një shteti ligjor dhe të një shoqërie demokratike. Në rrugëtimin kundër korrupsionit, ashtu siç thamë më lart, po trajtojmë vendimin e Gjyqartit Agim Bendo, i cili ka një eksperiencë të gjatë si gjyqtar në Gjykatën e Shkallës së parë të Tiranës. Kemi parasysh kohën që ky gjyqtar kryesonte trupin gjyqësor me pjesëmarrjen e dy ndryshuesve të ashtuquajtur të "plepave", që gjykuan një çështje pronësie të një shtetasi që kishte ndërthurur një banesë kasolle me konstrukcion dërrasë e qereste, në një pjesë të oborrit të shtëpisë së një banori autokton të Tiranës z. Salih Lami, të cilin ja uzurpuan padrejtësisht të gjithë truallin, përpara shtëpisë, duke e detyruar të hynte në banesën e tij nga një rrugë tjetër. Këtu po paraqesim përmbajtjen e vendimit nr.4807, datë 23.09.1997 "... Me vendimin nr.1008, datë 28.12.1994, Komisioni i pronave midis të tjerave i ka kthyer të paditurve, trashëgimtarëve Lami një sipërfaqe trualli në të cilën ndodhet banesa private e paditësit me oborrin e saj përkatës. Me padinë në gjykimin paditësi kërkoi përfundimisht blerjen e këtij tualli nga ana e tij. Ndërkohë trashëgimtarëve Lami mparaqiten gjatë gjyqimit një kundërpadi me anë të së cilës kërkohet lirimin e këtij trualli, lidhjen e kontratës së qirasë për një sipërfaqe 77.5 m² trualli e pagimin e qerave të pa paguara. Nga gjykimi i zhvilluar për këtë çështje rezultoi e provuar si më poshtë: Paditësi Abdyl Koçiu ka një shtëpi private me dhomë, një guzinë, korridor, banjë e anekse të tjera ndihmëse, si dhe një obor të ndodhur në rrugën "Ali Bahushi", nr.111 Tiranë. Aty ai banon prej një periudhe përmbi 20 vjet. Ndërsa kjo shtëpi në atë kohë është ndërthurr pa leje, ajo është bërë pjesë e ligjshme në vështrimin të nenit 169, dhe 1164 të Kodit Civil. Përveç kësaj për truallin ai presupozohet që ka qenë edhe në kushtet e mirëbesimit, kjo nisur dhe nga vendimi nr.3427, datë 16.5.1996 i Gjykatës së Rrethit Tiranë, dokumentat e tjera të ndodhura në dosje. Pra paditësi e ka poseduar qetësisht edhe truallin përmbi 20 vjet, duke qenë kështu në mirëbesim për këtë truall që e ka zënë me banesën e tij. Nga ana tjetër, siç përcaktojnë ekspertët oborri i shtëpisë është pjesë funksionale e kësaj të fundit. Pra kemi të bëjmë me një send që duhet të ndjekë fatin e sendit kryesor. Siç shikohet këto dy sende të palujtëshme përbëjnë një tërësi të vetme, pra një sipërfaqe të përgjithshme trualli prej 1865 m². Në këto rrethana gjykata çmon se kjo sipërfaqe duhet të blihet nga pala paditëse kundrejt çmimeve të ekonomisë së tregut, të përcaktuara nga ekspertët, në variantin e dytë të aktit të ekspertimit. Përveç bazës ligjore të përmendura në arsyetimin e mësipërm, kjo blerje kushtëzohet edhe në vështrimin të nenit 175/4 të ligjit 7698, datë 15.4.1993 "Për kthimin e pronave" Po për arsyet e mësipërme gjykata e çmon kundërpadinë e paraqitur nga trashëgimtarët Lami si të pabazuar në procedurë ligjore. Për këto arsye Gjyka-



Veprimet korruptive të Bendos

ta bazuar në nenin 306 e vijues të K.Pr.Civile Vendos: Detyrimin e të paditurve, kundërpaditës trashëgimtarëve të të ndjerit Salih Lami (Hatibe, Vjollca, Gugash e Mimoza Lami) për të shitur palës paditëse Abdyl Koçiu një sipërfaqe trualli prej 1865 m². Kjo sipërfaqe ndodhet në rrugën "Ali Brahushi", Tiranë dhe në të ndodhet banesa pronë private në oborrin përkatës të paditësit. (Nga kjo sipërfaqe 108.2 m² është e zënë nga ndërtime e paditësit të kundërpaditur dhe 86.3 m² është obor (shih akt ekspertimit e plan vendosjen e bashkëngjitur). Ky truall do të shitet sipas variantit të dytë të paraqitur nga ekspertët, pra me 4000 lekë të reja për m², gjithsej trualli që do të shitet kp vlerën e përgjithshme prej 746806 lekë të reja. Rrëzimin e kundërpaditës së pabazuar në procedurë e në ligj. Mbi ankimin e banorit autokton të Tiranës, të paditurit kundërpaditës Salih Lami, Gjykata e Apelit Tiranë, më vendimin nr.627, datë 3.3.1998, megjithse ka gjetur në vendimin e gjyqartit Agim Bendo dhe ndihmësve të tij shkelje të rënda procedurale dhe zbatim fiktiv të dispozitave ligjore, për të mbështetur padinë e padrejtë të Abdyl Koçiu, por bie vetë në shkeljet e rënda procedurale, sepse pa asnjë kërkesë të paditësit vendos

tësisht ka vendosur: Ndryshimin e vendimit civil Nr.4807, datë 22.9.1997 të Gjykatës së Rrethit Tiranë si vijon:

- 1.Pranimin e padisë së paditësit kundërpaditur Abdyl Koçiu, duke anuluar vendimin e KKPr.Nr.1008, datë 28.12.1999 për sipërfaqen 133.3 m² që zë shtëpia 47 m² dhe oborr funksional 86.3 m².
- 2.Detyrimin e paditësit të kundërpaditur Abdyl Koçiu të lidhë kontratë qiraje me të paditurin kundërpaditës për sipërfaqen 53.3 m² që zënë objektet e ndërthuara pa leje.
- 3.Lënimin në fuqi të vendimit të mësipërm për pjesën që ka rrezuar kundërpadinë, për pjesën që është kërkuar, lirimi e dorëzimi i truallit dhe pagimin e qirasë së paguar.
- 4.Rrëzimin e kërkesës së paditësit kundërpaditur Abdyl Koçiu për detyrimin e të paditurve kundërpaditës për shitblerjen e truallit. Edhe Gjykata e Kasacionit ka pranuar këtë arsyetim ligjor të Gjykatës së Apelit Tiranë, duke i konsideruar veprimet e trupit gjyqësor në krye Agim Bendo në shkelje të rënda të procedurës civile dhe zbatimit të gabuar të akteve ligjore e nënligjore në fuqi. Këtë konkluzion kjo Gjykatë supreme e ka aritur me vendimin nr.846, datë 30.6.1998 të mospranimit të rekurisit të paraqitur nga paditësi Abdyl Koçiu. Pas studimit të kësaj dosje Shoqata parashtron shkeljet e kryera nga të tri nivelet e gjykatave për këtë Çështje civile, që konsistojnë:

- 1.Shkelje të kërkesave të nenit 42 të Kushtetutës, pasi është zhvilluar një proces jo i rregullt ligjor.
- 2.Janë shkelur kërkesat e nenit 6 të K.Pr.Civile sepse gjykata nuk është shprehur për gjithshka është kërkuar në mënyrë të veçantë nga pala e padi-

tur me përfaqësues trashëgimtarët e të ndjerit Salih Lami.

- 3.Janë shkelur kërkesat e nenit 10 të K.Pr.Civile sepse vendimi i gjykatës nuk është mbështetur mbi faktet e paraqitura nga palët gjatë procesit gjyqësor.
- 4.Janë shkelur kërkesat e nenit 16 të K.Pr.Civile sepse gjykata e ka bazuar vendimin e saj vetëm mbi pretendimet e palës paditëse me përfaqësues Abdyl Koçiu.
- 5.Janë shkelur kërkesat e nenit 20 të Kodit të Procedurës Civile pasi gjykata nuk ka ndjekur dhe zbatuar parimin e kontradiktoritetit, sepse ka mbështetur vendimin pa lejuar palët që të debatohet me njëra tjetrën në procesin gjyqësor.
6. Jaë shkelur kërkesat e nenit 29 të Kodit të Procedurës Civile, sepse vendimi është mbështetur vetëm në mbivlerësimin e pretendimeve të njerës palë, asaj të përfaqësuar nga Abdyl Koçiu.
7. Janë shkelur kërkesat e nenit 225 të K.Pr.Civile sepse gjykata ka caktuar ekspert pa marrë mendimin e palës së paditur, përfaqësuesve të të ndjerit Salih Lami, duke dhënë një vendim gjyqësor krejtësisht të njëanshëm e të çnueshëm.

Lidhur me këto vendime haptazi të padrejta, që kanë kaluar në të gjitha shkallët e gjyqimit dhe kanë marrë formën e prerë, Shoqata e Avokatëve Anti-Korrupsion ka mendimin që t'i drejtohet organeve të larta të pushtetit legjislativ, për të gjetur mundësinë e goditjes së këtyre vendimeve dhe të rikthimit të të drejtave të shkelura të qytetarëve nga veprimet korruptive të rënda dhe të hapta pa respektuar aktet ligjore të vendit dhe ato ndërkombëtare.



Drejtësi për të gjithë!

Më datë 24 Korrik 2013, në orën 13.00 një grup nismëtarësh themeluan Shoqatën e Avokatëve Antikorrupsion. Në këtë mbledhje themelimi ishin të pranishëm. Intelektualët Ndue Pjetra, Suarda Dalipi, Flovian Musta, Ledia Hasanaj, Henti Ahmataj, Suzana Skeja, Besar Kali dhe Ledia Doku. Më poshtë po japim të plotë proccverbalin e kësaj mbledhjeje.

HAPJA E Mbledhjes

Sot, më datë: 24 Korrik 2013, ora: 13:00, ne pjesmarrësit e sipërcituar deklarim të hapur Mbledhjen e Parë dhe mbajmë Procesverbalin përkatës që pasqyrojnë vendimet që do të merren në këtë Mbledhje të Parë.

THEMELIMI

Në procesverbalin e mbledhjes së parë thuhet: "Ne pjesmarrësit, Ndue Pjetra, Suarda Dalipi, Flovian Musta, Ledia Hasanaj, Genti Ahmataj, Suzana Skeja, Besar Kali dhe Ledina Doku, në cilësinë e anëtarëve themelues kemi menduar të themelojmë një Organizatë Jofitimprurëse. Për sa më sipër, ne anëtarët themelues, madhorë dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar, me vullnetin tonë të lirë e të plotë dhe të gjithë sëbashku, vendosëm: Themelimin e Organizatës Jofitimprurëse "SHOQATA E AVOKATËVE ANTI-KORRUPSION SHQIPTARË", me siglën "SH.A.A.SH." dhe hartimin e miratimit të Aktit të Themelimit dhe Statutit të Organizatës Jofitimprurëse. Në vijimësi të mbledhjes së parë, ne anëtarët themelues kemi hartuar Aktin Themelues dhe Statutin e Shoqatës "Shoqata e Avokatëve Antikorrupsion Shqiptarë", në vijim "SH.A.A.SH.", që vendosëm të krijojmë, të miratojmë Aktin e Themelimit dhe Statutin e Organizatës Jofitimprurëse "SHOQATA E AVOKATËVE ANTI-KORRUPSION SHQIPTARË", me siglën "SH.A.A.SH." Në pikat kryesore të Aktit të Themelimit dhe të Statutit janë: KRIJIMI DHE BAZA LIGJORE ku "SH.A.A.SH." do të jetë një organizatë jofitimprurëse me anëtarësi, e pavarur, joqeveritare, jopolitike, e krijuar me vullnet të lirë nga ana e themeluesve të saj, e cila nuk ka qëllime fitimi dhe është e hapur për bashkëpunim për të gjithë ata që punojnë për realizimin e qëllimeve të saj. Ajo do të funksionojë në përputhje me:

- Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë;
- Ligjin Nr. 8788, Datë: 07. 05. 2001 "Për Organizatat Jofitimprurëse", (i ndryshuar);
- Aktin e Themelimit;
- Këtë Statut; dhe
- Legjislacionin në fuqi.

Ja pse u krijua Shoqata e Avokatëve Antikorrupsion



ELIMINIMI I GABIMEVE DHE RRIJTJA E DIVERSITETIT

- a) Nxitja e pjesmarrjes së plotë dhe të barabartë:
 - të profesionit të juristit;
 - të sistemit të drejtësisë nga të gjithë personat;
 - b) Eliminimi i njëanshmërisë në profesionin ligjor dhe në sistemin e drejtësisë.
- AVANCIMI I SUNDIMIT TË LIGJIT**
- a) Rritja e të kuptuarit publik të ligjit;
 - b) Respektimi i sundimit të ligjit dhe të procesit ligjor;
 - c) Roli i profesionit ligjor në shtëpi dhe në të gjithë botën;
 - d) Të mbajë qeverinë të përgjegjshme në bazë të ligjit;
 - e) Të punojë për të mbështetur ligjin, duke përfshirë të drejtat e njeriut dhe një proces të rregullt ligjor;
 - f) Sigurimi i jashtë kuptimplotë në drejtësi për të gjithë personat;
 - g) Ruajtja e pavarësisë së profesionit ligjor dhe gjyqësor;
 - h) Denoncimi i rasteve korruptive dhe i rasteve të shkeljes së procedurave ligjore.

Shoqata ushtron aktivitetin e saj në respektim të përkatësive të ndryshme politike, fetare, gjinore, kulturore, racore dhe kombëtare. Shoqata nuk ndjek qëllime propagandistike, politike apo fetare dhe ushtron veprimtarinë e saj në mënyrë të pavarur nga interesat politike apo shtetërore.


OBJEKTIVAT:

1. PËRMIRËSIMI I PROFESIONIT TË AVOKATIT.

- a) Nxitja e cilësisë ligjore;
- b) Promovimi;
- c) Sjellja etike;
- d) Kompetencat;
- e) Profesionalizmi;
- f) Promovimi i shërbimit publik në profesionin ligjor.

IDENTITETI:

- 1. Emërtimi: "SHOQATA E AVOKATËVE ANTIKORRUPSION SHQIPTARË"
- 2. Sigla: "SH.A.A.SH."
- 3. Selja: Adresa: Rruga "5 Maji", Pallati i "Shkodranëve, Tiranë.
 - Shoqata do të hapë edhe degë e filiale në qytete të tjera brenda dhe jashtë R.SH.-së dhe Emërtimi i degës do të jetë në formën "SH.A.A.SH. / Emri i qytetit - Shteti.
- 4. Shoqata do të ketë simbolin dhe vullnën e saj identifikuese.
- 5. Kohëzgjatja: Pa një afat të paracaktuar.



QËLLIMI DHE FUSHA E VEPRIMTARISË

- 1. Qëllimi dhe fusha e veprimtarisë do të jenë:
 - 1) Përmirësimi i profesionit ligjor, duke eliminuar paragjykimet dhe diversitetin;
 - 2) Rritje e avancimit të sundimit të ligjit në të gjithë territorin e Shqipërisë;
 - 3) Hulumtimet rreth vendimeve të drejtës që mund të jepen në çdo shkallë të gjyqësorisë;
 - 4) Monitorimi dhe denoncimi i fenomeneve negative, që çënojnë drejtësinë shqiptare
 - 5) Inkurajimi, ndihma, përmirësimi dhe promovimi i parimeve të transparencës së drejtësisë dhe llogaridhënies së organeve publike, të administratës, gjyqësorit, etj;
 - 6) Hulumtimi, zbardhja dhe denoncimi i veprave korruptive nga punonjësit të administratës publike, të oficerëve të policisë, të prokurorëve dhe gjyqtarëve, veprime që çënojnë të drejtat dhe liritë themelore të njeriut;
 - 7) Monitorimi i respektimit nga organet publike dhe shtetërore dhe atyre të ruajtjes së rendit të të drejtave dhe liritë themelore të njeriut;
 - 8) Monitorimi dhe denoncimi i pabarazisë së qytetarëve përpara ligjit dhe i rasteve të diskriminimit padrejtësisht për shkaqe si: gjinia, raca, feja, etnia, gjyha, bindjet politike, fetare a filozofike, gjendja ekonomike, arsimore, sociale ose përkatësia prindërore;
 - 9) Monitorimi dhe denoncimi i fenomeneve negative, që çënojnë shoqërinë shqiptare;
 - 10) Inkurajimi, ndihma, përmirësimi dhe promovimi i parimeve të transparencës, drejtësisë dhe llogaridhënies nga ana e organeve publike, institucioneve administrative, gjyqësore, etj;
 - 11) Hulumtimi, zbulimi dhe demaskimi i veprave korruptive, që çënojnë të drejtat dhe liritë themelore të njeriut si edhe Legjislacionin në fuqi, vepra të kryera nga punonjësit të ndryshëm në institucionet e Administratës Shtetërore, në Komisarariatet e Policisë, në Prokuror, Gjykatat, etj.;
 - 12) Monitorimi i respektimit nga organet publike e shtetërore dhe nga organet e ruajtjes së rendit të të drejtave dhe liritë themelore të njeriut dhe denoncimi i rasteve të shkeljeve të këtyre të drejtave;
 - 13) Monitorimi i ruajtjes së dinjitetit të qytetarëve, të drejtësisë ndaj shtetasve shqiptarë, rendit publik, pluralizmit, identitetit kombëtar dhe trashëgimisë, bashkëjetësjes fetare dhe çdo të drejtë që gëzojnë shtetasit konform legjislacionit në fuqi dhe denoncimi i rasteve kur konstatohen shkelje të këtyre të drejtave;
 - 14) Monitorimi i respektimit të të drejtave të pakicave fetare dhe grupeve të tjera shoqërore dhe denoncimi i rasteve të shkeljes së këtyre të drejtave;
 - 15) Monitorimi i barazisë së qytetarëve përpara ligjit dhe denoncimi

- i rasteve të diskriminimit padrejtësisht për shkaqe të tilla, si gjinia, raca, feja, etnia, gjyha, bindjet politike apo fetare, gjendja ekonomike, arsimore, sociale ose familjare;
 - 16) Monitorimi dhe denoncimi i rasteve të shkeljes së lirisë së shprehjes, masmedias dhe i rasteve të censurës mbi mjeket e komunikimit dhe informimit;
 - 17) Hulumtimi dhe denoncimi i rasteve të shkeljes së të drejtës ligjore të individit për të marrë informacion dhe për të tërhequr dokumentacione të ndryshme pranë Institucioneve publike dhe shtetërore, dokumentacione mbi të cilat kanë të drejtë sipas ligjit;
 - 18) Monitorimi i respektimit të etikës nga punonjësit e administratës shtetërore kundrejt shtetasve që paraqiten në zyrat e këtyre institucioneve;
 - 19) Botimi i Akteve të ndryshme ligjore e normative, sipas mënyrës së parashikuar me ligj;
 - 20) Hulumtimi dhe denoncimi i rasteve ku shkelen të drejtat e shtetasve për kompensim dhe dëmshpërbim sipas legjislacionit, në raste të fatkeqësive natyrore, lëvizjeve sizmike, etj.;
 - 21) Denoncimi i rasteve të diskriminimeve, të dhunës, torturës, trajtimit çnjerëzor ose posthëtrues të individit, vepra këto të dënuara me ligj, që mund të ushtrohen padrejtësisht edhe nga funksionarë të ndryshëm, kryesisht të policisë;
 - 22) ushtruar mbi shtetasit, si edhe të fenomeneve të ndryshme që çënojnë individin;
 - 22) Denoncimi i rasteve të konfliktit të interesave të institucionet e administratës shtetërore, policisë, prokurorisë dhe gjykatave;
 - 23) Denoncimi i rasteve të shpërdorimit të detyrës nga administratë publike dhe shtetërore;
 - 24) Pjesmarrja në fazat e diskutimit të debeteve të grupeve parlamentare për çështjet, që kanë të bëjnë me hartimin dhe ndryshimin e legjislacionit, me impact të gjerë publik;
 - 25) Përkrahja e zhvillimit dhe bashkëpunimit midis shoqatave simotra brenda dhe jashtë vendit;
 - 26) Ruajtja e standartit etik të miratuar gjërësisht nga opinioni publik;
 - 27) Lobimi për çështjet, që lidhen me jurisprudencën, ekonominë dhe çështjet të ndryshme legjislativë, që prekin pjesën më të madhe të shoqërisë;
- Përveç pikave të mësipërme, mund të përfshihen edhe veprimtari, aktivite apo sipërmarrje të tjera të ligjshme, të cilat do të konsiderohen e vlerësohen të nevojshme dhe që do të konsistojnë në përmirësimin e qëllimit dhe objektivave të prishme të Shoqatës. Këto shtesa e ndryshme do të miratohen e nënshkruhen nga Asambleja e Përgjithshme dhe do të pasqyrohen në Statut.

- T Ë ARDHURAVE**
- 1. Burimet e të ardhurave të "SH.A.A.SH." - së do të jenë:
 - a) Kuotizacionet e anëtarëve në masën 5,000 (pesë mijë) lekë në vit për çdo anëtar;
 - b) Koutat e pjesëmarrjes në aktivitetet e ndryshme;
 - c) Grante, sponsorizime apo dhuratat;
 - d) Donacione nga institucione qeveritare dhe joqeveritare;
 - e) Kontributet vullnetare nga anëtarët;
 - f) Të ardhura të tjera në përputhje me ligjin.
 - 2. Fitimet e realizuara nga veprimtaria e "SH.A.A.SH." do të përdoren në mënyrë ekskluzive për zbatimin dhe zgjerimin e objektit të veprimtarisë së Shoqatës, në përputhje me qëllimin e krijimit të saj;
 - 3. Shpërndarja e fitimit gjatë aktivitetit të "SH.A.A.SH." është e ndaluar.
- ANËTARËSIA**
- 1. SH.A.A.SH." është e hapur për:
 - a) Juristë e avokatë profesionistë;
 - b) Njësitë të profesioneve të ndryshme, që kanë njohuri dhe/ose interes për ligjet.
 - 2. Anëtarësia nuk mund të tjetërsobet dhe as të kalohet me anë të trashëgimisë.
 - Kushtet e anëtarësisë përcaktohen në statut.
 - Kuota e anëtarësisë do të jetë 5,000 (pesë mijë) lekë të reja.

- ORGANET DREJTUESE**
- 1. Organi më i Lartë vendimarrës i Shoqatës është **Asambleja e Përgjithshme**, e cila zgjedh për një afat 4 (kater) vjeçar, Bordin Drejtues, i cili përbëhet nga:
 - a) Kryetari;
 - b) Nënkyetari;
 - c) Sekretari;
 - d) Financieri dhe
 - e) Një Anëtar i plotë.
 - Ø Kjo Mbledhje e pare, krijoi dhe Bordin Drejtues, i përbërë nga:
 - 1. Ndue PJETRA
 - 2. Ledia HASANAJ
 - 3. Suarda DALIPI
 - 4. Flovian MUSTA
 - 5. Besar KALI
- Bordi Drejtues, pasi tërhiqet për vendim, me votim të fshehtë zgjedh Kryetar të shoqatës dhe të tij, Av. Ndue PJETRA dhe si Nënkyetare të shoqatës dhe të BD zgjedh: Av. Ledia HASANAJ.
- 2. Organet e tjera ekzekutive të "SH.A.A.SH." - së janë:
 - a) Bordi Mbiqyrtës Financiar;
 - b) Kryetari.
 - c) Nënkyetari;
- Personi i Autorizuar me të drejta të plota për të depozituar kërkesën e dokumentacionet dhe për të ndjekur procesin e regjistrimit të shoqatës, si person juridik pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, do të jetë N.Kryetarja Ledia HASANAJ". Të gjitha këto janë të shkruara në procesverbalin e mbledhjes së parë të themelimit të kësaj shoqate.

Një gjëmë e madhe po i kanoset Shqipërisë nga sistemi gjyqësor

Një gjëmë e madhe po i kanoset sot Shqipërisë në formën e një mallkimi. Ky mallkim është më i tmerrshëm se ai i shtrigave, më i rrezikshëm se kafshimi i gjarpërinjve, me pasojë më të mëdha se kolera dhe me shtrirje gjeografike në gjithë territorin e Republikës, duke ia kaluar kështu çdo tërmeti shkatërrues. Sipas analizave social-politike, ka një garanci absolute se avancimi i kësaj diagnoze e çon drejt vdekjes, çdo lloj shoqërie njerëzore. Po ç'është ky tërmet, kjo çarje e tokës, kjo murtajë apokaliptike që rrezikon të gjëlltisë perspektivën e një kombi të tërë? Ndryshe, nga metastazat e kancerit që i marrin jetën një njeriu të vetëm, fantazma që kërcënon vendin tonë synon t'i marrë frymën dhe të paralizojë të ardhmen e një shoqërie. Dhe ky është korrupsioni galopant që po zhvillohet çdo ditë e më shumë në sistemin e drejtësisë. Në tentativën 24 vjeçare të pluralizmit shqiptar, në vend që ne, të forconim kolonat e sirtsemit të drejtësisë, kemi bërë të kundërtën, duke ushqyer dhe forcuar mikrobet dhe brejtësit e këtij sistemi. Oktapodët me tetë këmbë të oqaneve nuk janë asgjë, para gjymtyrëve të rrezikshëm të korrupsionit që shtrihet ngado nëpër gjykata, duke i krijuar vetes një pushtet absolut brenda shtetit. Fijet e mirimangave të bodrumeve janë si lodra kalamajsh para fijeve të dukshme e të padukshme që e lidhin mafien e drejtësisë me atë të politikës. Dhe kjo lidhje e rrezikshme krijon një qark të shkurtër që hedh në erë të gjitha përpjekjet njerëzore për të ndërtuar një jetë të qetë e normale. Sepse në këtë mënyrë, "siguresat" e fatit të çdo njeriu ndodhen në "kabinën elektrike" të sistemit gjyqësor, ku nga momenti në moment, nëse vazhdon kjo gjendje, mund të hidhet në erë e gjithë shoqëria. Kjo edhe për faktin se në batalionin e të korruptuarve janë rreshtuar edhe politikanët e lartë të Shqipërisë të cilët janë akuzuar dhe kanë dalë në gjyq për afera të rënda korruptive. Të gjithë ne, e dimë se Rama është akuzuar për tenderat e Bashkisë së Tiranës, Meta është akuzuar për pazaret e hidrocentraleve, në bazë të incizimeve të bëra nga Dritani, ndërsa Berisha është akuzuar për vrasjet e 21 janarit. Nga ana tjetër, ish Kryeministri i parë i sistemit tonë pluralist, Fatos Nano është dënuar me burg për vjedhje të donacioneve italiane ndaj Shqipërisë. Kjo tregon qartë se ne, periodikisht jemi drejtuar dhe po drejtohem nga njerëz të korruptuar dhe të inkriminuar. Kjo dukey qartë edhe nga akuzat që ata i bëjnë njëri-tjetrit kur u prishen pazaret e pista. Dhe në bazë të një deduksioni të shpejtë, duke qenë se politikanët shqiptarë janë kontigjentë të krimit, apo të hajdutërisë, atyre u duhet në çdo rast aleanca e pushtetit të Drejtësisë. Por të një drejtësie të kthyer së prapthi, për të shpëtuar lëkurët e tyre. Kjo atmosferë e inkriminuar e politikës shqiptare i frymëzon oktapodët e mafias në sistemin e drejtësisë, sepse ata e dinë mirë shprehjen që "njerëzit rrinë me ata që i ngjajnë". Dhe në këtë rast politikanët e inkriminuar dhe të turpëruar brez pas brezi për mashtrimet që po u bëjnë shqiptarëve, afrohen në aleanca të fshehta me prokurorët dhe gjyqtarët të cilët nga ana e tyre duan ta kenë rrugën e lirë për të zhvatur sa më shumë para nga njerëzit e thjeshtë. Dhe qytetarët shqiptarë të tronditur nga ky realitet i pashpresë kërkojnë çdo ditë rrugët e largimit nga Shqipëria për shkak se shpresa e tyre e fundit, që ka të bëjë me vendosjen e drejtësisë, në fakt, është shuar e para. Shqipëria tani mund të quhet pa frikë si vendi ku fajtorët bredhin me makina të shtrenjta dhe me kobure në brez, ndërsa të pafajshmit përfundojnë nëpër burgje. Këtu, ai që ka prona të ligjshme brez pas brezi, fle çdo natë me një batanije në stacionin e trenit, sepse dokumentet e pronësisë së tij i disponon dikush tjetër me letra false. Por Bertold Brehti thotë: "Nëse ne luftuam natë e ditë kundër padrejtësisë dhe nëse ne u mundën prej saj, kjo nuk do të thotë aspak se padrejtësia paska të drejtë".

editoriala



Bankat hajdute, ja si po grabisin xhepat e qytetarëve

Komisioni i mirëmbajtjes për llogarinë bankare në varësi llojit të valutës u vjedh klientëve 10 dollarë ose 10 euro në muaj

Ekspert Financiar: Genti Ahmetaj

Vetëm për taksën e mirëmbajtjes së llogarisë bankare për personat fizike dhe sistemin e tyre bankat kërkojnë lekë ndaj çdo klienti. Kështu taksa e mirëmbajtjes së llogarisë bankare për personat fizike dhe juridike është e ndarë sipas valutës. Komisioni i mirëmbajtjes për llogarinë bankare për një periudhë 3 muaj, në varësi llojit të valutës është përkatesisht: 600.00 (gjashtëqind) Lekë, 6.00 (gjashtë) USD, dhe/ose 6.00 (gjashtë) Euro. Ndërsa për qytetarët, të cilët kanë një llogari rrjedhëse, komisioni i mirëmbajtjes së llogarisë është 300.00 Lekë, 3.00 USD dhe/ose 3.00 Euro. Sipas informacioneve, rezultoni se për rreth 80% të bizneseve që koeporojnë në Shqipëri, llogaritë bankare janë të hapura në Lek dhe në Euro; 10% kanë llogari në Lek, Euro dhe USD, ndërsa 10% i mbetur kanë llogari vetëm në Lek. Rreth 60% e qytetarëve që kanë llogari personale, i kanë ato në Lek dhe në Euro, ndërsa pjesa tjetër rreth 40% i kanë llogaritë vetëm në Lek ose vetëm në Euro. Numri i qytetarëve, që kanë një llogari personale është minimumi 400 mijë persona, që do të thotë 400 mijë llogari bankare. Referuar për llogaritjetve të thjeshta vlefta e paguar bankës është: 400,000.00 qytetarë x 100.00 Lekë në muaj x 12 muaj = 480,000,000.00 Lekë në vit - Numri mesatar i bizneseve në Shqipëri është rreth 127,342 biznese dhe për llogaritjet do të ishin: 127,342.00 biznese x 200.00 Lekë x

12 Lekë në muaj = 305,620,800.00 Lekë

- Nëse për llogarisim faktin se rreth 60 mijë biznese kanë numër llogarie edhe në Euro, do të kishim: 60,000 biznese x 2 Euro x 12 muaj = 1,440,000.00 Euro, / ose 201,600,000.00 Lekë. Pra, në përfundim shifra mesatare që bankat përfitojnë nga klientët e ndryshëm të saj, qofshin këta biznes apo qytetarë, vetëm për taksën e mirëmbajtjes së llogarisë bankare, është

rreth 987, 220, 800.00 Lekë në vit ose 9.8 milionë USD. Për samësi për, ijemi drejtuar edhe Kryeministrit si edhe Ministrisë së Financave, meskresat përkatëse, me Nr. Prot. 84 / 1, Nr. Prot. 85 / 1, Datë: 02.10.2013. Në këto shkresa kemi kërkuar marrjen e masave emergjente për ndryshime në ligjin Nr. 9662, Datë: 18.12.2006 "Për Bankat në Republikën e Shqipërisë". Më poshtë po paraqesim kërkesën ronë drejtuar Ministrisë Shkëlqim Cani.

Nr. Prot. 84/1

Tiranë, më datë: 02. 10. 2013

Lënda: Kërkesë

Drejtuar: Z. Shkëlqim Cani

Ministria e Financave

"Shoqata e Avokatëve Antikorrupsion Shqiptarë", regjistruar me Vendimin Nr. 3635, Datë: 30. 07. 2013 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, dhe e pajisur me NIPT: L32022451L, me seli në Tiranë, paraqet kërkesën si më poshtë vijon: Nga ana jonë, kohët e fundit janë konstatuar një sërë shkellesh nga ana e Bankave të Nivelit të Dytë në Republikën e Shqipërisë. Konkretisht, Komisionet Bankare për Mirëmbajtjen e Llogarisë Bankare që i paguhen nga banka, për një periudhë 3 muaj është:

-Për personat fizik dhe juridik: 600.00(gjashtëqind) Lekë, 6.00 (gjashtë) USD, dhe/ose 6.00 (gjashtë) Euro

-Ndërsa për qytetarët, të cilët kanë një llogari rrjedhëse personale, ky komision është 300.00 Lekë, 3.00 USD dhe/ose 3.00 Euro.

Në një përllogaritje të thjeshtë, taksa e tarifës së mirëmbajtjes së llogarisë bankare që një Bankë vjedh çdo vit nga Klientët e saj është rreth 4,000,000.00 USD. Ligji Nr. 9662, Datë: 18.12.2006 në nenet e tij, i ka lënë dorë të lirë bankave në përcaktimin e tarifave dhe taksave të ndryshme, që një klient i një banke duhet t'i paguajë kësaj të fundit. Taksat dhe Tarifat që i paguhen Bankës, nuk janë vetëm përqindjet e përcaktuara nga specialistët e kredive, në momentin kur një person merr një hua nga kjo bankë, por edhe taksat e e mirëmbajtjes së llogarisë bankare, të cilat përcaktohen nga vetë këto Banka. Çdo bankë e nivelit të dytë, përcakton sipas rregullores së saj të brendshme taksën e mirëmbajtjes së llogarisë bankare, qofshin këto personale apo llogari biznesi. Nga ana tjetër çdo person apo biznes, në momentin e kryerjes së pagesave të ndryshme pranë bankës, është i detyruar të paguajë një komision banker, i cili në përllogaritje me numrin e klientëve të bankave, arrin shifra vërtet të larta, shifra këto që janë në kumiz e në dëm të qytetarit. Të gjitha këto veprime dhe caktim taksash e tarifash për komisione të ndryshme nga ana e Bankave të nivelit të dytë, nuk monitorohen në mënyrë korrekte dhe të drejtë. E në këtë mënyrë Bankat kanë dorë të lirë të marrin të ardhura e të përfitojnë nga qytetarët, të cilët shpesh herë janë të detyruar t'i drejtohen këtyre bankave. Të vetëdijshëm se sistemi financiar e tatimpagues imponon pagesën e komisioneve bankare, por tarifat duhet të jenë më të llogjikshme dhe më të pranueshme për buxhetin e çdo qytetari të Shqipërisë. Për këtë arsye, jemi të mendimit, që duhet të ndërmerren masa për ndryshime në ligj, në mënyrë të tillë, që bankat e nivelit të dytë të mirëmonitohen rregullisht dhe që të jenë të kufizuara në vendosjen e tarifave dhe taksave që u vjelin qytetarëve. Theksi duhet vënë në taksën e mirëmbajtjes së llogarisë bankare, personale ose biznesi, duke përcaktuar një nivel kufi të detyrueshëm për këto banka. Për sa më sipër, bazuar edhe në objektivat e pasqyruara në Statutin e Shoqatës, statuti i cili është miratuar me Vendim Gjykatë, Kërkojmë nga ana Juaj: Të ndërmerren masa për rishqyrtimin e Ligjit Nr. 9662, Datë: 18.12.2006 "Për Bankat në Republikën e Shqipërisë".

Duke ju falenderuar për mirëkuptimin, mbetemi në pritje të përgjigjes Tuaj!

Me konsideratë:

KRYETARI

Av. Ndue PJETRA

Av. Ndue PJETRA

Sot në vendin tonë kemi një bum arrestimesh për veprën penale të Prodhimit, Trafikimit, Kultivimit dhe Shitjes të lëndëve Narkotike dhe të gjitha gjykatat e vendit janë në dilemë dhe prandaj lind pyetja për gjyqtarët, se si duhet të veprojnë përpara si për ketë denimeve. Aktualisht masat e denimit janë të parashikuara në Kodin Penal, por sipas ngjarjeve të fundit nuk janë të parashikuara për të gjithë sh-

qipëtarët njësoj. Në masat e dënimeve nuk është parashikuar lloji dhe sasia e lëndës Narkotike përpara si për ketë denimit por është e njëjtë si për Kanabis sativa hashash dhe drogat e tjera si për shembull, Kokaina, ose Heroina. Aktualisht, në gjykatën e Tiranës po gjykojnë shumë persona që po dënohen për 3, 10, apo 25, gram dhe dënimet e tyre parashikohen minimumi 5 vite burgim. Lind pyetja se si do veprohet me dënimet e tyre në kohën kur kemi më shumë se 3, ose 4


Të bëhen ndryshime në Kodin Penal për lëndëve narkotike

mijë persona në Lazarat, që duhet t'i nënshtrohen këtyre dënimeve, por aktualisht ata kanë konsumuar veprën penale të prishimit dhe të shitjes të pa diskutueshme dhe nuk dënohen, ndërsa këta që e perdorin për veten e tyre dhe atyre që iu është gjendur në xhepat e tyre, dy apo tre cingare duhet të vuajnë denimin në burgjet shqiptare.

Kush mund të ndërhyjë lidhur me përcaktimin e kësaj situatë, pasi kemi të bëjmë me cenimin e barazisë brenda shtetit? Si duhet të veprojnë gjyqtarët lidhur me masat e vendimeve? Po Prokuroria dhe Policia si duhet të veprojnë në këtë rast? Këto janë një sërë pyetjesh që nuk mund të marrin përgjigje ligjore në kushtet ku

ndodhemi. Mendojmë se ka ardhur koha të bëjmë një anmisti të përkohshme për sa i përket këtyre veprave penale dhe të ndëhyhet me shumë urgjencë për të bërë ndryshimet e domosdoshme në Kodin Penal dhe të Procedurës Penale përpara si për ketë veprën Penale të Kultivimit Shitjes dhe të Trafikimit të Lëndëve Narkotike.

Një Kallëzim Penal kundër AKKP-së, në mbrojtje të pronës së shqiptarëve



Shoqata e Avokatëve Antikorrupsion Shqiptarë ka kërkuar vazhdimisht mbrojtjen e pronës së shqiptarëve. Duke hedhur në gjyq institucionet drejtuese, apo menaxhuese të shtetit. Kjo ka ndodhur në dhjetra raste, por më poshtë po e konkretizojmë përkushtimin e pakursyer të kësaj shoqate me një kallëzim penal që i ka bërë AKKP-së, në mbrojtje të pronës qytetare. Kjo ka ndodhur në mars të këtij viti dhe vazhdon të ndodhë çdo ditë me ata që shkelin ligjin. Në këtë kallëzim thuhet teksteve: "Shoqata e Avokatëve Antikorrupsion Shqiptarë, është një organizatë jofitimprurëse, e cila ka si qëllim kryesor të saj in hulumtimin, ndjekjen dhe denoncimin e çdo rasti korruptiv dhe/ose antiligjor, që kryhet nga nëpunës administrate, oficerë të policisë gjyqësore, prokurorë, gjyqtarë, etj. në dëm të qytetarit të thjeshtë. Në kuadër të qëllimeve dhe objektivave të shoqatës, dhe legjitimuar me Vendim Gjykatë, Shoqata "SH.A.A.SH." ka të drejtë të kërkojë çdo lloj dokumentacioni nga institucione të ndryshme shtetërore, si edhe nga kompani e firma private, në momentin kur konstaton dhe ngre pretendime të bazuara në ligj, lidhur me pretendimin se është kryer një veprim antiligjor apo korruptiv. Në këtë mënyrë, pranë Shoqatës "SH.A.A.SH." ka ardhur denoncimi i një rasti, ku pretendohet se nga ana e Agjencisë së Kthimit dhe Kompensim-

it të Pronave Shkodër, në bashkëpunim me institucione të tjera janë kryer disa veprime antiligjor, lidhur me falsifikimin e dokumentave të pronësisë, që kanë dëmtuar shtetasin Prel Martin Gjoli. Ngjarja, që ka çuar Z. Prel Gjoli të kërkojë ndihmën tonë është si më poshtë vijon: Shtetasi i sipërcituar ka blerë një sipërfaqe prej 700 m² në vitin 2001 nga shtetasi Prek Hanxhari. Në vitin 2004 ka ndërtuar shtëpi banesë me sip. 140 m², sipër këtij trualli. Ndërkohë, në vitin 2010 më dijeni se pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër ishte ngritur një padi kundër Z. Gjoli, padi kjo e ngritur nga Z. Nikolin Kujxhia, i cili si trashëgimtar i Znj. Gjyljana Bushati pretendonte se ishte pronar i territorit prej 4.000 m², ku përfshiheshin 500 m² nga sipërfaqja e truallit, që kisha blerë unë, sipas Vendimit të vitit 1995 të Agjencisë së Kthimit dhe Kompensimit të Pronave Shkodër. Dhe në këtë mënyrë, Z. Nikolin Kujxhia pretendonte se gëzon të drejtën e privatizimit. Nga dokumentacioni, që i është paraqitur Gjykatës në atë kohë, kam konstatuar se Vendimi i regjistrimit të pasurisë nga Zyra e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Shkodër, kjo pronë ishte regjistruar në Dhjetor 2010. Gjithashtu, një fakt me rëndësi për t'u përmendur është fakti, që Z. Nikolin Kujxhia pretendon se në këtë tr-

all ekziston një kaptan automatësh, për të cilin Komisioni i vlerësimit i ngritur nga Zyra e Urbanistikës Shkodër ka regjistruar se aty ekziston ky kaptan. Në realitet, në të nuk ekziston një ndërtesë e tillë. Fakt, që faktin këtë pretendim është edhe Harta e vitit 2002. Në këtë territor ka vetëm disa ndërtesa të Ndërmarrjes së Gjeologjisë, si dhe shtëpia që ka kam ndërtuar unë dhe jo ndonjë kaptan automatësh. Ndërkohë Komisioni i Vlerësimit të objekteve për nxjerrjen në ankand për efekt tenderi ka regjistruar edhe një kaptanone inekzistent. Bazuar në këto konstatime dhe fakte, me të drejtë pretendojmë se Z. Nikolin Kujxhiiu, në bashkëpunim me Hipotekën e Shkodrës, Aluzinin Shkodër, Drejtorinë e Gjeologji - Minerave, si edhe me ekspertët Ing. Tymbetari dhe dhe Ing. Qerimaj kanë falsifikuar dokumentacionin dhe në shkelje me ligjin kanë dëmtuar të drejtën e përfittimit të pasurisë ndaj shtetasit Prel Gjoli. Për të hulumtuar dhe ndjekur me konkretisht rastin, në mënyrë që të kërkonim rivendosjen e një të drejte legjitime, e cila është shkelur në dëm të qytetarit Prel Gjoli, i kemi kërkuar Agjencisë Kombëtare të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave Tiranë, nëpërmjet shkresave zyrtare, dosjen ku përfshihet Vendimi Nr. 621, Datë: 04.09.1995 të Agjencisë së Kthimit dhe

Kompensimit të Pronave Shkodër. Nga ana e kësaj Agjencie na kanë ardhur shkresa refuzuese, lidhur me kërkesën tonë, si fillim duke pretenduar se duhet kopje origjinale e Vendimit të Regjistrimit të Shoqatës, Ekstrakti i shoqatës, etj. Pasi i kemi depozituar edhe personalisht pranë Agjencisë këto dokumentacione, përfundimisht kërkesa jonë është refuzuar. Këtë refuzim të dhënies së dokumentacionit në fjalë nga ana e Agjencisë së Kthimit të Kompensimit të Pronave dhe konkretisht Drejtoreshës së Përgjithshme, Znj. Sonila Qato, e konsiderojmë antiligjor dhe pretendojmë se po kryhet me qëllim dashakeqas, për të vazhduar spekulimet lidhur me falsifikimin e dokumentacionit, duke rritur dëmtimin ndaj qytetarit Gjoli. Pretendimet tona se ekzistojnë shkelje ligjore nga ana e Agjencisë së Kthimit dhe Kompensimit të Pronave dhe Drejtoreshës së saj, Znj. Sonila Qato, i bazojmë në dispozita ligjore dhe konkretisht:

- 1. Ligji Nr. 8788, Datë: 7.05.2001 "Për regjistrimin e Organizatave Jofitimprurëse".**
- 2. Neni 39 i Kodit Civil** citon: "Shoqata është person juridik që krijohet me vullnetin e lirë të pesë ose më shumë personave fizikë ose jo më pak se dy personave juridikë që ndjekin një qëllim të caktuar, të ligjshëm, në të mirë dhe në interes të publikut ose të anëtarëve të saj."
- 3. Neni 6, pika 2/ 4) i Statutit të shoqatës "SH.A.A.SH." "Qëllimet e Shoqatës"** citon: "Rritje e avancimit të sundimit të ligjit në të gjithë territorin e Shqipërisë";
- 4. Neni 7, pika 3, gërma: h), objektivi i shoqatës është:** "Avancimi i Sundimit të Ligjit";
- 5. Vendimi Nr. 3635, Datë: 30.07.2013 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë,** i Regjistrimit si person juridik të Shoqatës së Avokatëve Antikorrupsion", e cila legjitimon të drejtën e Shoqatës për të kërkuar kopje dokumentacionin nga institucione të ndryshme;
- 6. Refuzimi i kërkesës për dhënie dokumentacioni nga ana e Agjencisë së Kthimit dhe**



Kompensimit të Pronave është në shkelje me **Nenin 301 të Kodit Penal**, i citon: "Kryerja e veprimeve për të ndryshuar vendin e kryerjes së veprës penale duke prishur, ndryshuar apo fshirë gjurmët e saj ose duke lëvizur, fshihur, asgjësuar, vjedhur, falsifikuar një send apo një dokument me qëllim për të vështirësuar dhe penguar zbulimin e veprës penale dhe të autorit të saj, dënohet me gjobë ose me burgim gjer në tre vjet."

7. Vonesat, që na kanë shkaktuar, duke pretenduar mungesë dokumentacioni, si edhe refuzimi përfundimtar i Agjencisë së Kthimit dhe Kompensimit të Pronave na jep të drejtën të pretendojmë se këto veprime të Agjencisë, me Drejtoreshën Znj. Sonila Qato, përbën Shpërdorim Detyre, sipas **Nenit 248 të Kodit Penal**, i cili citon: "Kryerja ose moskryerja me dashje e veprimeve a e mosveprimeve në kundërshtim me ligjin, që përbën mospërbushje të rregullt të detyrës, nga personi që ushtron funksione publike, kur i kanë sjellë atij ose personave të tjerë përfitime materiale ose jomateriale të padrejta a kanë dëmtuar interesat e ligjshëm të shtetit, të shtetasve dhe të personave të tjerë juridikë, nëse nuk përbën veprë tjetër penale, dënohet me burgim deri në shtatë vjet dhe me gjobë nga treqind mijë deri në një milion lekë."

Për sa më sipër, bazuar në Ligjin për Organizatat Jofitimprurëse, Statutin e Shoqatës "SH.A.A.SH.", Vendimin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, Nenin 39 i Kodit Civil, Nenin 301 dhe 248 të Kodit Penal, po paraqesim përpara Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë, këtë **Kallëzim Penal ndaj Agjencisë së Kthimit të Kompensimit të Pronave Tiranë, përfaqësuar nga Drejtoresha e Përgjithshme Znj. Sonila Qato, duke kërkuar marrjen e masave për fillimin e procedimit ndaj të kallëzuarës.**

Me konsideratë:
KRYETARI
Av. Ndue PJETRA

Metamorfioza

Nga Albert Vataj

Të ndodh të trokasësh në një portë të rëndë, shumë të rëndë. Të trokasësh gjatë, shumë gjatë. Më në fund, kjo portë hapet. Para syve të tu të velur nga mundimi dhe kurrizin e përthyer nga nënshtrimi, të shfaqet pors një vegim një portret shumë i njohur. I vendosur mbi një masiv mish të taposur deri në grykë me sajdisje të modës së fundit, ai portret megjithëse i llyrosur mundte ta shquante si shumë të njohur. Para teje, pors një shtatore në paradhomën e një legjende, shtriet një njeri shumë i njohur. S'ka nevojë për shumë vramëndje. Ku dhe si njihemi. S'ka nevojë për të rrënuar gjatë në kujtesë. Po. Ai ishte, tamam ai me të cilin kishe lidhur krahët në kordonin e vijës së parë të revolucionit antikomunist. Nuk ka pikë dyshimi është tamam ai. Po. Nise të mbusheshe gjoksin me frymë si horizonti në të zbardhur. Sapo mobilizohesh të marrësh veten, të drejtosh kurrizin, të hovësh në drejtqendrimin sublim dhe sytë të plazmojnë më qartë. Një, çfarë

kërkoni?! Jam i zënë, nuk mund t'iu pres, të shkërmoq si një vazo geramike kur shembet përdhe. Toni i tij i ashpër, aspak miqësor dhe dashamirës. Hija e tij prej plumbi dhe vështrimi përcmues, përplasja para hundëve e derës së rëndë të pushtetit, janë të mjaftueshme që ti të marrësh zvarrë mishin tënd të pavlerë dhe grumbullin e kockave dhe të zvarresh i tërhequr nga dëshpërimi në rrugën e kthimit. Ti ishe aty për të kërkuar një të drejtë. Apo jo. Nuk ishe për të përfiturur një privilegj. Tash nuk mund t'i kesh asnjëherë. Ajo që të ka mbetur është vetëm zhgënjimi. Kthehesh si një ushtri e mundur duke lëshuar hijen që ta ha perëndimi. E ndërsa përpiqesh të pranosh të mundurin brenda teje, sakaq ke pranuar njëzëri gjithçka tjetër. Ishte një ditë pa fat, do mendosh. Nuk ishte dita jote. Oh sa shumë ditë nuk janë të halexhiut. Provon përsëri. E ke menduar gjatë, ke pranuar të bësh një kompromis me veten tënde. Vendosi të mos jesh ai që ke nderuar dhe të ka nderuar. Një metamorfozë ia vlen. Fundja tjetërsimi është përshatje, apo jo. E kush do t'ia kish-

te ngenë të të paragjykonte, nëse ti ke vendosur të jesh koherent. Pra të përpiqesh të kapësh hapin e kohës. Vendosi të jesh tjetër kush dhe përpiqesh ta bësh këtë, dhe shpreson t'ia dalësh. Var me kujdes në raftin e rrobeve të gjitha, moralin, principet, nderin. Të gjitha. Dhe vesh kostumin e turpit që ke huajtur nga koha. Iyshitur nga domosdoja e pasjes së kësaj të drejte, vendos ta kërkosh atë, tashmë jo si të drejtë legjitime, por si një privilegj, si një përfitim, si një grabitje. Se domosdo ajo që ti do të marrësh, ai që do të ta japë do t'ia marrë dikujt tjetër. Ti do ta kesh dhe ja ku je posedues i saj. Nuk ma do mëndja se ka shpëtuar ndonjë shpirt pa mëkatuar, ndonjë sedër pa u përlyer në jargavitet dhe përmjerrjet e shtirjeve, a ndonjë konstrukt principesh të nalta pa u gjuhëzuar në këtë batak që kudërbon. Me fjalë të tjera, korrupsioni ka qenë dhe mbetet jo vetëm një bashkëjetesë. Aq domosdo është bërë në të tashmën kjo sëmundje, sa gjithçka që kemi është në një ndërvarësi me këtë. Si antikorpe që kryejnë shërbimin në mbrojtje të organizmit tonë nga

mikroorganizma vrastare. Koincidence?! E drejta e çdokujt për të qenë korrupsionist ose i korrupsionist është një e drejtë që buron nga rrethanat shoqërore, kushtet dhe botëkuptimi i brezit në tërësi dhe i individit në veçanti. Migjithatë ajo nuk gjehet e përligjur në asnjë motivim rrethor dhe ndikues. Është individ ai duhet të ndeshet me atë vetete që qaset ta nënshtrijë duke e vendosur në pozitë e atij që i dorzohet rrethanave. Korrupsioni, ose prirja për të përfiturur ç'ka nuk të takon, ose për të patur si përfitim atë që është legjitime, ngarendje të ndryshme logjikimesh përpigjen ta lidhin me vështirësitë ekonomike, me një lloj të drejtë që një pjesë e hallkave të shtetit ose të shërbimeve e përvetësojnë në emër të rivendosjes në vend të vlerësimit të tyre. Nga një anë atë vetëqihen të diskriminuar financiarisht nga politikat jokohorentë që zbaton shteti. Nga ana tjetër, ata e kanë të kushtëzuar të jenë piratë ose gjobëvënës për detyrimin e tyre ndaj viktimës. Këta janë kontingjenti i grabitësve. Pa

tu dridhur gjuha mund të thuash se këta janë kriminelë ekonomik. Por nuk duhet të harrojmë dhe bashkautorin në këtë krim. Lind pyetja si janë ata aty. Në një dikaster të pushtetit qendror, në një zyrë të shërbimit komunal apo në një hallkë të shërbimit social dhe shëndetësor, e në këtë kryerendje është drejtësia që e ka mision të pamundur të bëjë drejtësi. Çfarë kishin ata më shumë se ti, apo se shumë e shumë të tjerë. Kushtetutshmëria partiake është një ndër shkaktarët dominues në çimentimin e një administrate që si bën syri tërt para asgjëje. Ai duke qenë i përkohshëm në këtë vend pune apo shërbim, ma do mëndja se ka bërë një hesap, gabim ose jo kjo s'ka rëndësi. Se sa do të jap për të patur këtë karrige, apo atë privilegj dhe sa do të përfitoj prej saj për aksh kohë. Me rastë nuk mjafton vetëm kontributi partiak, militantizmi, angazhimi dhe sakrificat. Këto për të qenë më të plota duhet të bashkëngjiten me një faturë, të cilën do ta përcaktojë ai, të cilit deri dje i ke shërbyer, ai për të cilin, deri dje ishe i gatshëm të sakrifikojë gjithçka, edhe jetën. A i'a vlen?!

Ferri Përse njeriu ka nevojë që e keqja të ndëshkohet?

Nga Vito Mancuso

"La Repubblica"

Ekziston ferri? Dhe nëse ekziston, cilët janë kriteret për t'u futur apo për t'u "arratisur" prej tij? Janë këto dy pikëpyetje të mëdha të ngritura nga diskutimi i fuqishëm i Papa Franceskut tre ditë më parë, kur e ka ngritur zërin kundër "kujt jeton në të keqen, blasfemon, shfrytëton të tjerët, i tiranizon, jeton vetëm për paratë, vanitetin, pushtetin". Kur ka bërë thirrje që të bëhet kujdes dhe "fra mos vendoset shpresa tek paratë, tek krenaria, tek pushteti, tek vaniteti". Kur ka thënë se të korrupsionarit nuk do të jenë të lumtur "në anën tjetër dhe për ta do të jetë e vështirë të shkojnë tek Zotit". Kur ka folur kundër atyre "që prodhojnë armë për të nxitur luftëra, që janë tregtarë vdekjeje dhe bëjnë tregtinë e vdekjes". Kundër këtyre, Papa ka deklaruar se "do të vijë një ditë kur të gjithë do të duhet të përgjigjen para Zotit". Fjalë që më kanë kujtuar dorën e ngritur të fra Kristoforit në shtëpinë e don Rodrigues dhe shprehjen e famshme të tij se "do të vijë një ditë", në kapitullin e gjashtë tek të "Të premtuarit për martesë". A ekziston gjykimi dhe ferri që e pason atë? A

ekziston pra një logjikë e botës, ku liria duhet të përgjigjet? Apo mos kjo ditë nuk do të vijë dhe nuk do të ketë gjykim, sepse nuk ekziston logjikë më e madhe se e njeriut, dhe bota është vetëm e të pushtetshmeve dhe mashtruesve? Shumë larg të dërguarit në trishimet e ferrit dhe skenarët groteskë me djaj dhe tridhembësh të nxehtë, ekzistenca e Ferrit të çon tek kuptimi kompleksiv i botës: nëse kjo udhëhiqet në finale nga një logjikë e të mirës dhe drejtësisë, të cilës liria i duhet t'i përgjigjet (duke u bërë e përgjegjshme), apo ndoshta jo, sepse ekziston vetëm arbitri dhe vullneti i pushtetit të individëve në konkurrencë mes tyre. Që në kohën e tij, Platoni ushqente bindjen se epërtej mjera rezervon "diçka shumë më të mirë për të mirët dhe jo për të këqinjët" dhe Kanti ka ana e tij ka pohuar: "Nuk gjejmë asgjë që të na ofrojë mundësinë e krahasimit në lidhje me fatin tonë në një botë të ardhshme, përveç gjykimit të ndërgjegjes sonë, ajo që gjendja jonë e tanishme morale na lejon të gjykojmë në mënyrë racionale" (Fundit i të gjithë gjërave). Të gjithë besimet e mëdhenj fetarë mësojnë se shpirti do të gjykohej: egjiptianët, përmes imazhit të psikostazisë dhe peshës së shpirtit (e

rimarrë edhe në mesjetën e krishterë), Zoroastrizmi dhe Islami përmes simbolit të urës eskatologjike, e hollësa një fije floku, mbi të cilën shpirtërat e rënduar prej mëkatit do të bien pa shpëtim, Induizmi dhe Budizmi përmes konceptit të karmas që përcakton rimëshërimet e ardhshëm. Skenari është kudo i njëjtë: 1. Ka një logjikë që strukturon ecurinë e botës. 2. Liria njerëzore thirret të përgjigjet. 3. Cilësia e përgjigjes përcakton gjykimin që pret, kur liria do të vihet përballë logjikës kozmike. 4. Gjykimi mund të rezultojë negativ. Ai që krishtërimi e quan Ferr, nga pikëpamja laike është dëshmtim, në kuptimin që liria mund të dështojë dhe një ekzistencë e tërë rezultojnë çuar dëm. Duke përmendur të korrupsionarit, trafikantët e njerëzve, tregtarët e vdekjes dhe në përgjithësi të gjithë ata, brendësia e të cilëve është e mbushur me lakmi dhe zili, papa Francesku nuk ka bërë gjë tjetër përveçse ka përsëritur sovranitetin e të mirës dhe drejtësisë (që një i krishterë e quan Zot) në këtë botë, si dhe përgjegjësinë që vjen si pasojë e saj, që është ai element që imponon një jetë në lartësinë e këtij rregullit fisnik. Natyrisht, prej kësaj nuk buron aspak siguria e ekzistencës së Ferrit-Parajsës dhe të

Zotit, të gjithë këto do të mbeten gjithmonë objekt i fesë. Prej kësaj buron një pyetje për çdo njeri të përgjegjshëm: dashuria për të mirën dhe për drejtësinë që ndonjëherë ndizet brenda nesh është vetëm një dëshirë e zjarrtë personale, apo është manifestimi i një logjike më të madhe, të cilës ne i përkasim që në krye të herës? Vijnë tek pyetja e dytë e ngritur prej diskutimit profetik të Papës, ajo e kriterëve që në gjykimin përfundimtar do të përcaktojnë humbjen apo shpëtimin. Tradita e krishterë pohon nga njëra anë se cili shpëton falë besimit, nga ana tjetër cili shpëton falë të mirave që bën. Po kujt i takon parësia? Besimit apo të mirës që ke praktikuar? Dhe kush do të shkojë në Ferr: jobsimitarët, apo ata që kanë bërë keq? Edhe sot e kësaj dite, disa të krishterë mbështesin alternativën e parë, duke këmbëngulur për parëndësinë e dimensionit etik për fatin përfundimtar që na pret, luajtur në tërësinë e vet në aderimin tek "skandalit" i besimit për të cilin fliste shën Pali dhe që është ilustruar në shprehjen e famshme të Luterit, i cili fronton tëqë njerëzit edhe pse mëkatonin, të paktën të besonin më shumë (pecca fortiter sed fortius crede). Pak ditë më parë, Papa ka thënë

ekzaktesisht të kundërtën: në Ferr do të shkojnë ata që bëjnë keq, të korrupsionarit, ata që jetojnë për paratë dhe i bëjnë keq tjetrit. Është mendimi i Jezusit, i cili në Ungjill paraqet kriteret e gjykimit final të bazuar jo në aderimin doktrinal, por tek praktikimi i të mirës: "Kisha uri dhe mëngopët, kisha etje dhe më dhatë për të pirë..." (Mateu, 25, 35 dhe 42). Edhe kjo është një bindje universale. Për t'u kufizuar tek feja e Egjiptit të lashtë, në peshën e shpirtit të të vdekurit, si kundërpeshë shërbente penda e perëndeshës Maat, personifikim i Drejtësisë. Por edhe më e spikatur është ngjashmëria mes pjesës së evangjelistëve të cituar dhe një pasazhi nga Lirini i të Vdekurëve: "Kam kënaqur Zotin me atë që do, I kam dhënë bukë të uriturit, i kam dhënë ujë atij që kishte etje, rroba atij që ishte lakuriq, një varkë atij që nuk e kishte". Këto fjalë janë shkruajtur 1500 vite përpara Krishtit. Prej teksteve të tillë buron e vërteta e Krishtëritimit, të vërteta ashtu si universaliteti ku bazohen të gjithë besimet fetare dhe që nuk u ka mundur asnjëherë njerëzve. Dhe pikërisht përmes kësaj gjuhe, papa Francesku u drejtohet të gjithë atyre që duan drejtësinë, pavarësisht se cilës je apo popull i përkasin.



Agim GJOLEKA, Anëtar i Gjykatës së Lartë (1992-99), jurist, këshilltar e Avokat i njohur, me kontribut të shquar në "mendimin teoriko-juridik shqiptar" si Gjyqtar në Gjykatën e Lartë, pedagog në Shkollën e Magjistraturës, këshilltar juridik në Ministrinë e Drejtësisë dhe autor librash të botuara në fushën e Drejtësisë: "Manual i akteve procedurale penale", "Komente mbi masat e sigurimit personal", "Avokati në Procesin Penal" botim i parë, "Avokati në Procesin Civil", botim i parë, "Mbrojtësi në masat e sigurimit personal", etj.






Ndue PJETRA, është diplomuar si ekonomist në Fakultetin Ekonomik, Shkodër, Diplomuar si jurist në Fakultetin Juridik të Universitetit "Luigj Gurakuqi", Shkodër. Këshilltar Juridik pranë Zv.Kryeministrit dhe Ministrit të Punës dhe Çështjeve Sociale. Zv.Drejtor i Përgjithshëm i SH.K.P. Avokat i njohur në fushat Civile, Penale dhe Administrative. Pedagog i lëndës Penale e Krahasuar, pranë SH.L.P. "Vitrina". Analist në media për problemet e drejtësisë. Kryetar i "Shoqatës së Avokatëve Antikorrupsion Shqiptar". Autor i librave në fushën e drejtësisë: "Avokati i Vetvetes" dhe "Udhëzues për Dëshpërblimet". Botues i gazetës investiguese "Mesazheri".

bootimet

Duke e konsideruar profesionin e avokatit të rëndësishëm, të domosdoshëm dhe mjaft të respektuar edhe në fushën administrative na bëri t'i kushtojmë një libër në formë manuali, për të ndihmuar sado pak që ai të bëhet sa më funksional, i dobishëm dhe zbatues shëmbullor i dispozitave ligjore e nënligjore në procesin gjyqësor administrativ dhe në çdo aspekt të veprimtarisë së tij. Në këtë libër menduam të trajtojmë veprimtarinë e avokatit dhe mjetet ligjore të reagimit të tij si përfaqësues në procesin administrativ dhe në atë gjyqësor administrativ, për mbrojtjen e të drejtave dhe interesave të personave të përfaqësuar në të gjitha fazat e tij, duke u munduar të bëjmë një analizë të qartë e të saktë juridike të ligjeve që i referohen rolit, të drejtave dhe detyrave të avokatit në këto procese, duke u paraprirë nga Kushtetuta e vazhduar më tej me K.Pr. Administrative, K.Pr. Civile, Ligjin Nr. 49/2012 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatave Administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative" si edhe nga ligjet e veçanta. Ky libër, ndjek librat "Avokati në Procesin Penal" dhe "Avokati në procesin civil" duke plotësuar tashmë rolin dhe të drejtat e detyrat e avokatit dhe në procesin gjyqësor administrativ, që nga fillimet e tij deri tek ekzekutimi i vendimit gjyqësor. Ai u vjen në ndihmë kryesisht avokatëve të rinj, në përfaqësimin përpara gjykatës të çështjeve administrative dhe u shërben atyre si manual në veprimtarinë e përditëshme, por edhe gjyqtarëve, drejtuesve të institucioneve të administratës publike, punëdhënësve të organeve publike dhe përmbartuesve, të cilët duke njohur më mirë të drejtat e avokatëve do të ndihmohen në kryerjen e veprimeve, përpilimin e akteve dhe marrjen e vendimeve sa më të drejta dhe të bazuara në ligj.

Avokati, njeriu i ligjit që përfaqëson dhe mbron të drejtën



"Nuk ekziston mënyrë më e mirë për të ushtruar imagjinatën se studimi i ligjit. Asnjë poet nuk do të interpretojë kurrë natyrën kaq lirisht sa një avokat të vërtetën"

Jean Giraudoux

Të ndëshkohen gjyqtarët dhe prokurorët e korruptuar, kujdes nga avokatët që janë kthyer në sekserë

Ndëshkim njerëzve të ligjit që shkelin ligjin

zgjidhja? Duhet denoncuar dhe ndjekur penalisht ata gjyqtarë, të cilët marrin rryshfete në këmbim të një vendimi në favor të personit që paguan nën dorë? A është kjo një mënyrë, për ta ndaluar korruptionin në shkallët e gjyqësorisë? Ne mendojmë se kjo nuk është e mjaftueshme. Duhet bërë diçka më shumë se kaq, për të evituar ose së paku për të ulur nivelin e korruptionit në gjyqësor, e cila vazhdon të mbetet një plagë e shqetësive të mëdha në shoqëri. Por cilat duhet të jenë hapat dhe masat që duhet të ndërmerren?

Fitet kaq shumë për korruptionin në administratë e më gjerë, aq sa kemi arritur në një stad të tillë indiference të të dorëzuarit përpara këtij fakti. Është diçka që ndodh çdo ditë në çdo zyrë administrative, në çdo zyrë gjyqësore. Të gjitha zërat rrëfjnë se gjyqtarët janë të korruptuar dhe për të fituar një çështje duhet të paguash. Mënyrat e pagimit janë duke gjetur një "sekser" ose duke e kthyer avokatit tënd përfaqësues, si të tillë. Korruptioni është një ves, i cili nuk lind me njeriun. Është krejtësisht absurd fakti, të mendosh se nuk mund të bëhet gjë, sepse një person është i korruptuar dhe kjo gjë nuk mund të zhbehet. Shoqata e Avokatëve Antikorruption Shqiptarë është e vetëdijshme për çdo akt korruptiv, që ndodh dhe është qëllimi i saj, që të hulumtojë rreth këtyre rasteve. E megjithatë cila mbetet

shpenzime të ndryshme, që një gjyqtar, si figurë publike duhet të ketë. Janë aq shumë gjyqtarë dhe aq shumë seanca të stërgjatura gjyqësore, sa që shpresë herë qytetarëve i'u humb durimi dhe i duhet të shpenzojë kohë dhe para për vite të tëra, deri të jepet vendimi përfundimtar nga Gjykata. Për këtë arsye dhe më gjerë, "Shoqata e Avokatëve Antikorruption Shqiptarë", sygjeron të ndërmerren këto hapa në lidhje me funksionimin dhe gjyqësorit në Republikën e Shqipërisë:

1. Përgjysmimi i numrit të gjyqtarëve, që gjykojnë çështjet;
2. Përcaktimi i afateve të kohëzgjatjes së seancave gjyqësore në çështjet civile;
3. Rritja e pagave mujore të

gjyqtarëve, diku rreth vlefës 3,000 Euro në muaj. Nëse ndërmerren këto 3 hapa, të thjeshtë për t'u vënë në zbatim, por me një rëndësi vërtet lartë, **rezultatet do të jenë:**

1. Kursimi i kohës dhe i parave për qytetarët, duke marrë vendimin përfundimtar, brenda një kohe të shkurtër, pa u sorollatur në dyert e gjykatave për vite me rradhë;
2. Gjykimi më i mirë i çështjeve nga ana e gjyqtarëve; dhe më kryesorja
3. Ulja në minimum e nivelit të korruptionit në gjyqësor, sepse një pagesë e mirë justifikon punën e mirë.

Gjithashtu, kjo reformë në gjyqësor do të ulë edhe koston që shteti duhet të paguajë për shpenzime

Të ndiqen penalisht ata gjyqtarë, që marrin rryshfete dhe të ndërmerren 3 masa emergjente për shpëtimin e sistemit gjyqësor

pagash për gjyqtarë. Këto para, që shetti paguan, në fund të fundit janë taksat e çdo qytetari, i cili nëse merr një shërbim të mirë dhe të denjë nga shteti i tij, të jeni të sigurt se bëhet i ndërgjegjshëm dhe zbaton me përpikmëri çdo ligj e çdo detyrim që ka ndaj vendit.

Në shumë raste janë konstatuar se gjyqtarët në një proces penal ka dhënë një masë dënimi më të lartë se ajo që ka kërkuar organi i akuzës. Për këtë arsye, sygjerohet që të përcaktohen individualisht rastet e tejkalimit të masës së propozuar nga prokurori, në dhënien e vendimit përfundimtar.

Ndryshimet që propozojmë për dëmshpërblimin e të dëmtuarëve

gjyqësor, këtë herë civil, për të kërkuar dëmshpërblimin, parashikuar nga Nenin 608 - 654 të Kodit Civil. Kjo nënkupton, shpenzim kohe dhe parash për të dëmtuarin. Arsyeja është, se me përfundimin e procesit penale, atij i duhet të kërkojë dëmshpërblimin në një tjetër proces gjyqësor, duke paguar edhe tarifën përkatëse, si edhe duke humbur kohë, siç ndodh rëndom në procese të

stërgjatura civile në Gjykatë. Këto arsye, shpesh herë e detyrojnë të dëmtuarin të mos kërkojë dëmshpërblim dhe si e tillë, atij i privohet e drejta për të kërkuar dëmshpërblimin, e drejtë legjitime kjo. Në Nenin 59 të Kodit të Procedurës Penale, parashikohet e drejta për të kërkuar dëmshpërblimin në të njëjtin proces penal, por nga kjo e drejtë privohet i dëmtuari nga vepra të tilla të zh-



dukjes, falsifikimit dhe vjedhjes së dokumenteve. Për sa më sipër, "Shoqata e Avokatëve Antikorruption Shqiptarë", i është drejtuar nëpërmjet dy shkresave zyrtare, Ministrisë së Drejtësisë dhe Kuvendit të Republikës, që të kryhet kjo shtesë në Nenin 59 të Kodit të Procedurës Penale: Aty ku citohet: "A1, që është dëmtuar nga veprat penale të parashikuara nga nenet 90, 91, 92, 112 paragrafi i parë, 119, 119/b, 120, 121, 122, 125, 127, 148, 149 dhe 254... të shtohen edhe nenet 186 dhe 192/a... të Kodit Penal ka të drejtë të paraqesë kërkesë në gjykatë dhe të marrë pjesë në gjykim si palë për të vërtetuar akuzën dhe për të kërkuar shpërblimin e dëmit."

gjykatë e pavarur dhe e paanshme e caktuar me ligj." Shtyrja dhe zgjatja e seancave gjyqësore lë vend për hipoteza korruptioni dhe si e tillë kemi kërkuar dhe sygjerohet që të ndërhyet në Kodin e Procedurës Civile, lidhur me afatet e këtyre proceseve gjyqësore civile. Duhet përcaktuar një hapësirë kohore e arsyeshme, nga seanca në seancë. **GJYKIM TË SHKURTUAR** Në proceset penale ndodh shpesh që gjykatat nuk pranojnë kërkesat e të akuzuarve për gjykim të shkurtuar, madje dhe në ato raste kur i padituri e pranon autorësinë e veprës penale. Për këtë arsye sygjerohet përcaktimi i këtij rasti në Kodin e Procedurës Penale, në mbështetje të Nenit 404 të këtij kodi.

MASA E DËNIMIT Në shumë raste janë konstatuar se gjyqtari në një proces penal ka dhënë një masë dënimi më të lartë se ajo që ka kërkuar organi i akuzës. Për këtë arsye, sygjerohet që të përcaktohen individualisht rastet e tejkalimit të masës së propozuar nga prokurori, në dhënien e vendimit përfundimtar.



Shoqata e Avokatëve Antikorruption Shqiptarë", në kuadër të objektivave dhe qëllimeve të saj, të pasqyruara në Statut, sipas hulumtimit që ka kryer, parashtron sygjerimet lidhur me disa shtesa dhe ndryshime në ligj. Gjatë hulumtimit, kemi kryer si shoqatë, kemi konstatuar një sërë rastesh të zhdukjes, vjedhjes dhe falsifikimit të dokumenteve, veprime këto të kryera kryesisht në Zyrën e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, nga ana e punonjësve të këtij Institucioni. Pjesë e këtyre rryshfeteve dyshohet se janë edhe persona me pozita të larta në shtet. Ndërkohë, që personit ndaj të cilit i është kryer kjo padrejtësi i duhet të harxhojë kohë dhe para, deri sa të rifitojë pronën e tij, duke i shkaktuar një dëm të dyfishtë dhe duke i dhënë të drejtën të kërkojë dëmshpërblim në Gjykatë. Kodi i Procedurës Penale, në Pjesën e Parë, Kreu VI të tij dhe konkretisht në Nenin 58 - 68, parashikon që qytetari ka të drejtë të paraqesë kërkesën penale duke paditur personin që ka kryer një veprë penale si vjedhje, zhdukje apo falsifikim të dokumenteve. Ndërsa në lidhje me dëmshpërblimin për dëmin, që i është kryer, ai duhet të hapë një tjetër proces

Prof. Dr. Lukas Gschwend
Univ. St. Gallen, Zvicër

Nga Zef Ahmeti
Univ. St. Gallen, Zvicër

E drejta penale në "Kanunin e Lekë Dukagjinit"



Shprehja shqiptare për të drejtën zakonore shqiptare është Kanun. Kjo fjalë është marrë nga gjuha sumeriane (gi, Rohr) dhe ajo akadiane (ganu, Rohr), për të ardhur tek gjuha Hebraike (qane, Rohr) dhe që andej është marrur tek gjeqishtja (kanna, Rohr) dhe kështu është zhvilluar më tutje në kanon, dhe kishte kuptimin e "rregull, normë". Me konceptin kanun në shqip kuptohet e drejta zakonore. Burimet e së drejtës zakonore të shqiptarët janë: Kanuni i Skënderbeut, Kanuni i Malsisë së Madhe, Kanuni i Labërisë, Kanuni i Lekë Dukagjinit (KLD). Në këtë punim unë do të trajtoj kodin penal në Kanunin e Lekë Dukagjinit (KLD), kanun ky më i njohuri tek shqiptarët.

Mbledhja e KLD-së në një formë të shkruar, nga forma verbale e zgjeruar e tij, është bërë nga françeskanin Shtjefën Gjegjovi nga Kosova. Këto norma të së drejtës zakonore të grumbulluara prej tij, në vitin 1913 filloi t'i publikonte në revistën e françeskanëve shqiptarë "Hylli i Dritës". Pas vrasjes së tij nga serbët më 14.10.1929, françeskanë të tjerë e sistemuuan materialin e mbetur dhe e publikuan atë nën emrin "Kanuni i Lekë Dukagjinit". E drejta zakonore "Kanuni" është i ndarë në 1263 nene dhe në 12 libra. Kanuni rregullonte si çështjet civile ashtu edhe ato penale. Ky Kod për shumë shekuj me radhë ishte në të njëjtën kohë edhe kushtetuta e shqiptarëve deri në Luftën e Dytë Botërore.

II. Kodi penal në "Kanun"

E drejta penale në Kanun ishte një përzierje mes të drejtës penale publike dhe vetëgjyqësisë. Sipas kësaj të drejte zakonore vetë personi natyror ishte i aftë për të mbajtur drejtësi (rechtsfähig). Në përonin bëhej dallimi mes vetë personit dhe pjesëve shtesë.

Për arsye të këtij dallimi, e drejta zakonore shqiptare mbronte këto të mira që vijnë:

- a. të mirat e trupit
- b. të shpirtit.

Në pjesën shtesë të një personi hynin: c. veprimet dhe d. raportet.

a. Të mirat e trupit

Sipas të drejtës zakonore shqiptare të mirat e trupit çenoheshin nga zënka, gjymtimi apo vdekja.

a. a. Zënka

Zënka ishte një konsekuencë e inatosjes, një ngatërrësë me fjalë apo kërcënim. Ngatërrësë ndërmjet të rriturve në njërin anë dhe e fëmijëve nga ana tjetër trajtoheshin në mënyrë të ndryshme. [10] Një ngatërrësë, e cila ndodhte mes dy të rriturve, dhe nëse prej saj rridhe gjak, konsiderohej më shumë si cënim i nderit sesa si cënim i trupit. Nëse dëmtimi i trupit nuk ishte aq i madh, i dëmtuari kishte të drejtë që ta nxjerrë dëmtimin (në trup) në të njëjtën mënyrë. Ngatërrësë në publik, si dhe ngatërrësë që binte në vesh të publikut, prodhonte një urrejtje në rritje dhe përfundonin shpeshëherë me vrasje.

Ngatërrësë ndërmjet fëmijëve nuk merreshin seriozisht. Edhe nëse një fëmijëve rrahe nga një burrë i fafesisht, presupohej se kjo kishte ndodhur si "dënim".

a. b. Gjymtimi

Me gjymtim kuptohej ndarja ose dëmtimi i një pjesë të trupit. Në Kanun si gjymtim konsiderohej një plagë, e cila shkaktohej me armë. E drejta zakonore shqiptare nuk bënte dallim të

madh ndërmjet gjymtimit të qëllim të dhe atij të paqëllim të. Gjymtimi i paqëllim të gjykohej me më tepër lëshim. Arsyeja e këtij ndryshimi jo të theksuar, mund të qëndronte në faktin që autori t'iu heqet mundësia, që të deklaronte në mbrojtje të tij, se akti ka ndodhur padashje, edhe kur ai ta kishte shkakuar plagën me qëllim. Me qëllim ishin rastet kur dikush e drejtonë armën me qëllim kundrejt një tjetri dhe e plagoste atë. Nga ana tjetër, nën gjymtimet padashje (të neglizhueshme), futeshin ato që ndodhin për ko incidencë, dhe kur plaga shkaktohej pa qëllim. Kjo ndodhte atëherë, kur dikush gjuante armikut të tij ndër-sa qëllonte një person tjetër (të pafajshëm).

Pavarësisht nga kjo, nëse dikush duke përdorur armë shkakonte një plagë me ose pa qëllim mbi dikë tjetër, i plagosuri kishte të drejtë të hakmerrej sipas principin "plagë për plagë".

a. c. Vrasja dhe gjakmarrja

Rreth gjakmarrjes në fiset shqiptare formohej "një historiografi e kategorisë" në vetë rreth historisë së gjakmarrjes, ku në këtë fushë kanë vepruar udhëtarë dhe shkencëtar austriak dhe gjermanë. Gjakmarrja për lexuesit (në perendim) u prezantua si diçka sensacionale. Varsisht nga autori, ata krijuan përshtypjen, se jeta në Shqipëri nuk kishte të bënte me gjë tjetër - veç rreth gjakmarrjes. Unë nuk jam i këtij mendimi.

autori (dorasi) duhej të informonte edhe publikun edhe familjen e viktimës, se ai kishte kryer gjakmarrjen. Në rastin e një vrasjeje apo gjakmarrjeje, ishte e ndaluar që të ushtrohej masakër mbi trupin e të vërrit. Nëse dikush, me ndonjë mjet, shtonte plagë të tjera pas vdekjes mbi trupin e viktimës, autori ngarkohej për vrasje të dyfishtë, që do të thotë se, ai mbante përgjegjësi jo vetëm për një vrasje, por për dy.

Gruaja mbetet e përjashtuar nga gjakmarrja. Kundër tyre (grave), askush nuk guxonte të ushtrojë gjakmarrje. Në anën tjetër, nëse nuk ka asnjë burrë në shtëpi, dhe familja nuk e kishte marrë gjakun, atëherë gruaja duhej të hakmerrej. Ajo mund të vritet vetëm në rastin e tradhëtisë, përndryshe vrasja e një gruaje - me ose pa qëllim - konsiderohej si turpërim i madh. Edhe arma, me të cilën ishte vrarë apo plagosur një grua, konsiderohej si e "pa vlerë" për tu përdorur për luftë.

Nëse autori, pa të drejtë ushtron gjakmarrje (për dikë tjetër), shtëpia e tij digjej dhe shembej, të gjitha pronat e tij të tundshme, si psh. mobiljet, drithi e bagëtia konfiskoheshin. Ai duhej të largohej nga prona e tij, dhe rajoni ku banonte, me të gjithë familjen, dhe të paguante edhe një dënim.

a. d. Ndërmjetësimi dhe dhënia e besës Ndërmjetësimi quhej ai person, i cili ndërhynte "për me da fjalët e kqia", që do të thotë, për të zburuar tensionin, si konsekuencë e një mos pajtueshmërie, e cila mund të çonte drejt hakmarrjes, vrasjes dhe zhvillimeve të tjera çënuese (§ 668). Ndërmjetësimi pranohej kudo që shkonte. Ndërmjetësimi mund të ishte një burrë ose grua (shumë rrallë dhe vetëm për gjëra të vogla), gjithashtu prifti (§ 669). Për të vendoset për një vepër të keqe, prifti ndërhynte jo "n'emen të vet", por në emrin e "Famullis-a n'emen të flamurit" (§ 675). Ndërmjetësimi ishin zakonisht burrat me eksperiencë.

Për të kërkuar besë, vrasësi, pas kryerjes së aktit, çonte ndonjë mik tek familja e viktimës, dhe kështu kërkonte disa ditë të lira (besë). Gjatë periudhës së besës, nuk lejohej të kryhej asnjë hakmarrje. Besa jepej tepër rrallë për personin që kryente vrasjen. Besa ishte në Kanun një periudhë e lirisë dhe e sigurisë, e cila garantohej nga shtëpia e të vërrit për autorin dhe familjen e tij, në mënyrë që të mos e kryejë gjakmarrjen përbrenda kohës sa ishte e dhënë besa. Dhënia e besës konsiderohej si një detyrim burrëror (§ 854). Kanuni njihiti dy lloje besash: 24 orë dhe 30 ditë. Nëse shtëpia e të vërrit jepte besën prej 24 orësh, dorëzimi merre të pjesë në ceremoninë e varrimit, edhe pse ai vetë e kishte vrarë. Kjo besë nuk zgjatej më tepër se 24 orë. Fshati mund të kujdesej për nxerjen e një bese prej 30 ditësh për dorasin dhe

familjen e tij. Nëse shtëpia e të vërrit nuk i jepte besë fshatit për familjen e autorit, atëherë autori dhe pjesëtarët e familjes duhej të qëndronin mbyllur; hynte një lloj arresti shtëpiak, burgu shtëpiak.

Gjatë "armëpushimit" të marrë përmes ndërmjetësimi në një rast gjaku, ishte e ndaluar të ushtrohej gjakmarrja. Sidoqoftë, nëse familja e viktimës vrante armikun (nxirrte hakun) para se të skadoj armëpushimi, atëherë marrësi i besës (dmth. ndërmjetësimi) duhej që të mirrte nxirrte gjakun në vend të të dëmtuarit në besë.

Ata, të cilët shkonin tek prindërit dhe kushërinjtë e të vërrit, në emër të autorit dhe shtëpisë së tij, që të kërkonin besë, quheshin bestarë. Ata konsideroeshin si mbrojtës të autorit dhe shtëpisë së tij, që atyre të mos ju ndodhë asgjë e keqe për kohën sa ishte dhënë besa.

a. d. a. Pajtimi dhe dorzanët e gjakut

Si ndërmjetësues tjerë në Kanun ishin dorzanët e gjakut. Dorzan ishte ai, i cili shkonte në shtëpinë e të vërrit dhe përpiqej të ndërmjetësoj pajtimin me dorërasin (autorin). Ndërmjetësimi (mund të ishin më shumë se një), kërkohet përkatësisht zgjedhje nga shtëpia e autorit (§ 972). Pajtimi i gjakut mund të arrihej në dy mënyra:

1. me të himë të dashamirvet të shpisi së të vërrit e të Famullitarit,
2. pagimi i parave për shtëpinë e të vërrit.

Shtëpia e të vërrit zgjedhte dorëzanët e të hollave të gjakut. Dorzani i gjakut ishte ndërmjetësimi, i cili ndërhynte, në mënyrë që të parandalonte "çdo të përsëritur mnijet e zjarmit" (§ 974). Pleq dhe burrat e urtë të atij vendi, përcaqtonin një periudhë kohe për pagesën të hollave për gjakun. Koha e përcaqitur për pagesën e parave nuk mund të zgjatej apo ndryshohej.

a. d. b. Vllaznimi, me pi gjak

Kjo gjë ndodhte, nëse dorërasin dhe shtëpinë e tij pajtohej me shtëpinë e të vërrit. Të involvuarit pinin gjakun e njëri-tjetrit. Në gota të vogla, të mbushura me raki ose ujë; ndonjëri prej dashamirësh lidhte gishtin e vogël të autorit, dhe e shponte atë me një gijlperë dhe e linte gjakun të rridhte në gotë. Kështu veprohej edhe me një anëtar (kryesor) të shtëpisë së të vërrit. Pas përzierjes së gjakut, të dy shkëmbenin gotat dhe kështu ata kryeqëzonin duart e pinin gjakun e njëri-tjetrit. Me "1000 thirrje përgëzimi ata qitnin me pushk në ajër" dhe bëheshin kështu nga armiq në vëllezër, siç çillohej në Kanun: "vllazet të ri të njëj nanet e babet" (§ 990).

b. E mira e shpirtit

Me të mirën e shpirtit kuptohej më tepër nderi. Sipas të drejtës zakonore shqiptare më mirë pranohej vdekja se sa dikush të prekej në nderin e tij. Cën-



imi i nderit bëhej në tre raste:
a. përdhunimi i grave,
b. ç'armatosja,
c. dhe nëse shkeleshin rregullat e mikpritjes.
Këto raste të shkeljes së nderit ishin aq të rëndë, sa ato mund të laheshin vetëm me gjak. Për këto shkelje të të mirave të shpirtit nuk kishte kurrëfarë mundësie as për falje e as që mund të përmirësohej me ndonjë formë të gjobës.

b. a. përdhunimi i grave
Ky krim ndodhte tepër rrallë. Por nëse merrej vesh se një grua ishte përdhunuar, përdhunuesi ndiqej dhe dënohej. Herët ose vonë, përdhunuesi duhej të paguante "me gjakun e vet" për aktin e tij. Sidoqoftë, nëse vërtetohet se marrëdhënia seksuale ka ndodhur me dëshirën e gruas, atëherë të dy paguanin këtë akt me gjakun e tyre. Nëse dikush shkante me një vajzë të fejuar, atëherë familja e autorit binte në gjak me familjen e të fejuarit. Nderi i gruas, ishte pjesë e nderit të burrit. Nëse burri ç'nderohej nëpërmjet gruas, ky ishte dhe cënimi më i rëndë i nderit të tij.

b. b. Cënimi i nderit me grabitje të armatosur

Cënimi i nderit me vjedhje të armatosur mund të bëhej në dy forma: atë publike dhe të fshehtë. Grabitja publike ishte e armës, ndodhte nëse dikush duhej të dorëzonte armën me forcë ose detyrim. Vjedhja e fshehtë e armës, nga ana tjetër, ndodhte gjatë natës ose gjatë ditës. Është interesante se kur grabitja (e armës) ndodhte publikisht - kjo trajtohej si turpësim i të vjedhurit. Nëkohësisht për atë (që iu ishte grabitur arma) ishte edhe cënimi i nderit të tij. Për këtë arsye i ç'nderuari nuk dilte në publik, derisa ai me gjak e lante "poshtërimin e madh" që i ishte bërë. Sanksionet për vjedhjen e fshehtë, ish-

in të moderuara. Cubit mund t'i kërkohet sidoqoftë një pagesë, e cila mund të shkante deri në lartësinë e një vrasjeje.

Cënimi i nderit nuk mund të paguhej me kontribute apo sende. Për nderin e marrë nuk kishte dënim. Ai nuk mund të kompensohej me gjëra, por vetëm me derdhje gjaku ose me pajtim pas nërmjetësimit të "dashamirve të mirë" (§597-600).

Një dallim tjetër e drejta zakonore shqiptare e bënte mes nderës vetjake (§593-601) dhe nderit shoqnor (§602-639).

b. b. a. Nderi vetjak

Kanuni i maleve shqiptare nuk e veçonte "nieren prej nierit" (§593). Për cënimin e nderit vetjak, Kanuni thoshte: "në daç, fale: po deste, laje ballin e vrugnuem" (§595), dmth. merr hak. Sipas §596, secili e kishte nderin për vetvete, dhe askush nuk mund të përziej. Existonte një lloj ndalimi i diskriminimit ndërmjet burrave. Jeta e të mirit dhe e të keqit kishin për rrjedhojë të njëjtën vlerë: "Kanuni i mban për burra" (§594). Mbështetur në këto dy rregulla, si dhe nga rregulli i §887, që thoshte: "cmimi i jetës së njeriut është i njëjtë si për të mirin, ashtu edhe për të keqin", mund të konsiderohet si një parim trajtimit të barabartë, e që aplikohet vetëm ndërmjet burrave. Marrja e nderit vetjak nuk mund të shpaguej me gjëra, por vetëm me gjak (vrasje) ose pajtim ("Ndera e marrun nuk shpërblehet me gja, por a me të derdhun të gjakut, a me të falun fisnikërisht." §598).

b. b. b. Nderi shoqëror

"Nderi shoqnor" mbulon çështjen e mikut në shtëpi, mikpritjen dhe të drejtën e shtëpisë. Ekskluzivisht kjo përfshinte të drejtën e mbrojtjes së mikut. [38] Këtu bëhej dallimi në mes shkeljes së mikpritjes [39] dhe të drejtës së shtëpisë. Këtë dallim do ta sqarojmë

E drejta penale në Kanun ishte një përzierje mes të drejtës penale publike dhe vetëgjyqësisë. Sipas kësaj të drejte zakonore vetë personi natyror ishte i aftë për të mbajtur drejtësi (rechtsfähig). Në personin bëhej dallimi mes vetë personit dhe pjesëve shtesë

me dy shembuj:

Shembulli 1: E drejta e (pronësisë së) shtëpisë

X vjen në shtëpinë e Y. Për aq kohë sa X ndodhet në shtëpinë e Y, Y detyrohet ta sigurojë X. Nëse i ndodhte Y diçka në shtëpinë e X, atëherë X detyrohet të marrte hak për Y, sepse ky akt dhune kundrejt Y konsiderohej si dhunim i banesës (shtëpisë).

Shembulli 2: Mikpritja

Me shkeljen i mikpritjes nënkuptohej: nëse Y ishte vetë dorasit dhe ndodhej (hyn gabimisht) në shtëpinë e X (të të dëmtuarit), atij në asnjë mënyrë nuk guxonte t'i ndodhte gjë nga X, derisa ai (Y ta lëshonte shtëpinë e X) të shkante në një shtëpi tjetër, pasi kjo kishte të bënte me shkelje e parimit të mikpritjes.

d. Vjedhja dhe grabitja

Sipas Kanunit me grabitje kuptohej fitimi i pronësisë me forcë mbi ndonjë send të huaj (§768 shkronja h, si dhe §777 v.), ndërsa vjedhja ndodhte fshehtas. Cubi, sipas Kanunit, ishte ai, i cili kishte vjedhur me dorën e vet (§768 shkronja a.). Grabitja me forcë kuptohej si cënimi i nderit.

c. a. Ndihmësi/bashkëfajtori

Pjesëmarrës në një vjedhje, sipas Kanunit ishin cubi, simahorët, ajo shtëpi, ku kishin ngrënë ose kishin marrë bukë hajdutët. Ndihmës ose bashkëfajtor ishte gjithashtu, ai që fshehte mallin e vjedhur ("paras cubi, paras kjoji", §768 shkronja d.). Nëse dikush ndihmte dikënd të nxirrte hakun edhe pse ai nuk ishte në gjak, ai binte në gjak (§831). Sanksionet për vjedhje të pasurisë rregulloheshin sipas parimit "dy për një". "Dy për një" praktikoheshin si për bagëti të vogla, poashtu edhe për të mëdha si dhe për sendin e vjedhur.

Shembull:

Nëse cubi vidhte një lopë, pronari i saj kishte të drejtë ta merrte atë përsëri, kudo që e gjente, edhe atëherë kur

dikush e kishte blerë lopën e vjedhur. Nëse shitësi (cubi) kapej, ai duhej t'i paguante pronarit shumën e dy lopëve për lopën e vjedhur, dhe pronari kompensohej në bazë të parimit "dy për një"; cubi ishte i detyruar gjithashtu, që t'ia kthente të gjithë shumën blerësit.

b. Hjekësi

Një formë tjetër e fajtorësisë në Kanun ishte hjekësi. Hjekësi ishte ai, që ndihmte dikë në një aktivitet kriminal (§766). Dënimet për një ndihmë të tillë ishin të ndryshme. Në rastin e dhënies së ndihmës për grabitje të një gruaje, ndihmësi binte në gjak dhe duhej t'i paguante fshatit një gjobë prej 100 groshë; gjithashtu edhe ai që jepte ndihmë në vrasje binte në gjak dhe duhej t'i paguante fshatit një gjobë prej 500 groshësh, po ashtu edhe për çdo vjedhje tjetër, që bëhej në fshat, ai gjobitej për veprën e tij si ndihmës, sipas rregullave të Kanunit, "menjëherë sapo hetohej" (§767).

III. Gjyqësia

E drejta zakonore shqiptare nuk njihje një gjyq në sensin e gjyqeve që kemi sot. Si gjyq konsiderohej kanuni i pleqnis. Pleq i ishin të parët e vllaznive ose krenët e fiseve. Pa pjesëmarrjen e tyre, çdo vendim apo veprim ishte i pavlefshëm (§993). Pleq thirreshin edhe burra me "za për urti" e "që janë regjë nder gjyqe e pleqni". Kanuni i pleqnis ishte i përbërë nga njerëz të zakonshëm, pa dallim të gjendjes së tyre sociale, prejardhjes së tyre apo dallimeve tjera. Ata bëheshin "gjykatës të popullit" vetëm nga aftësia e tyre që kishin për t'i kuptuar shpejt rrethanat dhe si gjykatës për t'i interpretuar ato me arsye dhe për të vendosur sipas rregullave të Kanunit.

a. Llojet e gjyqeve

E drejta zakonore shqiptar njihje dy lloje kanune pleqnish. Për pleqni të vogla (§998) merrreshin më vjetrit në fshat "permbas vllaznijet e fisit", të cilët

merrnin vendim për mosmarrëveshje të vogla. Çështjet serioze, të cilat cënonin nderin e gjithë fshatit dhe fisit, gjykohehin prej "Pleqvet e katundit e prej krenvet të Flamurit" (§1003). Që të mund të merrej një vendim, pleqtë dhe krenët e flamurit, duhej "t'i ken (kishin) me veti Pleqt e Strapleqt e katundit", në të cilin gjendej i fajtori (§1004). Nëse një vendim kishte të bënte me të gjithë fshatin, apo fisin, një plak vetëm nuk kishin të drejtë ta merrte çështjen në dorë. Në këso raste, "këto peshoheshin prej Pleqvet e Krenvet të kanus së Katundit e të Flamurit" (§1009). Kanunit të pleqnis i nënshtroheshin të gjithë, dmth. "edhe pse Plak, a Krye, ai i Derës së Gjonmarkut, pengun do ta lshojë në dorë të Pleqvet e Voglis, po bani kush vaj mbë të" (§1014).

b. Të drejtat dhe detyrimet e pleqve

Edhe pleqtë, të cilët vepronin si gjykatës, kishin sipas Kanunit të drejtat dhe detyrimet e tyre. Bazuar në §996, pleqtë kishin të drejtë, ta menjanojnë çdo mosmarrëveshje dhe kërcënim dimesh e kërcënim për vrasje, "ku me urti, ku me fuqi" bashk me gjithë fshatin, ndërsa për kërcënim serioze mund të lypnin "krahin e Krenvet e të djelmvet të Flamurit, per me prum në mend të dalunin mendësh." Për më tepër, nëse dikush nuk donte të rrespektonte vendimin e paanshëm, pleqtë mund të thirrmin takim me gjithë fshatin. Nëse vendosej për një çështje dhe palët pendoheshin që i kanë dhënë "pengun Pleqvet", ata më nuk kishin mundësi t'i ndërrojnë pleqt e as "t'ua sernmarrin pengun" (§1001).

Detyrimi i pleqve ishte të mos mbanin anë dhe "pa u thye prej mendoresha të folmesh prej nja it tjetrit" (§1015). Nëse ndodhte që këto detyrime shkelleshin nga ndonjëri prej pleqve, ai nuk zgjidhej më për/në kanunin e pleqnis. (Vijon)





për të ndërlikuar veprimet e organizatës me zbulimet e huaja, ka punuar vetë dhe ka ngarkuar pjesëtarët e organizatës për të goditur e sabotuar vijën e partisë dhe së bashku me armiqtë, që punonin në Ministrinë e Brendshme ka qenë bashkëpunëtorja më e afërt e poliagjentit Mehmet Shehu. Ja se çfarë pohoi vetë ajo në seancë: "Organizata jonë në fillim ishte e vogël, më vonë me porosi të agjunkturave të huaja u shtua me anëtarë të rinj. Detyra ishte të mbanim konspiracion, prandaj përdorej lidhja dyshe. Të gjithë pjesëtarët e organizatës kishin për detyrë t'i raportonin poliagjentit Mehmet Shehu. Po kështu, të pandehuri Llambi Ziqishti, duke qenë ministër i Shëndetësisë i është ngarkuar si detyrë kryesore përgatitja e kushteve për eliminimin fizik të Udhëheqësit të Partisë e të Popullit dhe sabotimi i vijës së partisë së sektorin ku punonte. Ish-ministrin e Jashtëm, Nesti Nase, Mehmet Shehu e përdorte për të gjetur rrugë për krijimin e lidhjeve me Perëndimin, sidomos me SHBA, e në mënyrë indirekte edhe me BS. Nesti Nase ka realizuar ndërlikimet e organizatës me emisarët e zbulimit amerikan e sovjetik. I pandehuri Skënder Shehu është aktivizuar e ka kryer detyra të rëndësishme në organizatën tradhtarë. Ky armik, me porosi së të atit poliagjentit Mehmet Shehu, ka qenë ndërlikuesi i organizatës me zbulimin amerikan dhe ka përgatitur kushtet për takimet agjunkturave që ka bërë Fiqirete Shehu me pelegrinazhet e saj jashtë shtetit, ka ndihmuar në veprimet përgatitore për eliminimin fizik të Sekretarit të Parë të KQ etj.

Vendimi për Fiqirete Shehun

Nga zhvillimi i gjyqimit rezultoi plotësisht e provuar se të pandehurit Fiqiret Shehu, Llambi Ziqishti, Nesti Nase e Skënder Shehu në bashkëpunim me agjunkturave e huaja kanë kryer veprime terroriste për eliminimin fizik të sekretarit të parë të Komitetit Qendror të Partisë së Punës së Shqipërisë. Të gjitha fitoret që ka arritur populli e Partia jonë, prestigji dhe autoriteti i madh që gëzojnë ato sot në botë, janë të lidhura pazgjidhshmërisht me shokun Enver Hoxha, themeluesin e Partisë sonë, luftëtarin e orëve të para kundër fashizmit e tradhtisë, kundër imperializmit e revizionimit, marksist-leninistit e shquar, njeriun më të dashur e të shtrenjtë të Partisë e popullit shqiptar. Prandaj është e natyrisht që tërë planet e armiqve tanë të jashtëm e të brendshëm kanë synuar edhe eliminimin fizik të udhëheqësit të partisë e të popullit. Për arritjen e këtij pikësynimi, poliagjenti Mehmet Shehu ka menduar e vepruar në bashkëpunim me padronët e tij



qysh gjatë Luftës Nacionalçlirimtare. Ai me porosi të anglezëve, gjatë operacionit të dimrit 1943-1944 nuk shkoi në Brigadën e Parë në ndihmë të Shtabit të Përgjithshëm, që qe rrethuar nga gjermanët me qëllim që të asgjësohej. Por siç dihet, jashtë vullnetit të armiqve kjo u evitua, shtabi e çau vetë rrethimin. Për këtë çështje, djali i tradhtarit Mehmet Shehu, i dënuar Bashkim Shehu ka deponuar: "Siç më ka treguar Mehmeti gjenerali anglez nëpërmjet oficerit anglez, që ndodhej pranë Brigadës së Parë kishte urdhëruar që brigada të mos shkonte në ndihmë të Shtabit të Përgjithshëm, ta linte shtabin të asgjësohej. Unë, më ka thënë Mehmet Shehu, e bisedova këtë gjë me Fiqirete Shehun dhe Tuk Jakovën dhe që të tre ramë dakord me urdhrin e anglezëve. E vonam disa ditë me radhë nisjen e brigadës në ndihmë të Shtabit të Përgjithshëm..." Të njëjtat mendime ka pasur edhe shoku i ngushtë i tradhtarit Mehmet Shehu, Nako Spiro, njeriu i jugosllavëve dhe i prapaksenës së Beratit, i cili duke e pasur fjalën për shokun Enver Hoxha, i ka thënë Naxhie Dumes në Berat "Nëse Komandanti nuk bindet e bind koburja". Siç rezultoi në hetuesi dhe në gjykim padronët i kanë dhënë Mehmet Shehut variante të ndryshme për të asgjësuar fizikisht Sekretarin e parë të Komitetit Qendror të Partisë së Punës së Shqipërisë. Zbatimin e kësaj veprë të poshtër terroriste Mehmet Shehu ka dashur ta realizonte në vitin 1973 me anën e mjekëve që po kuronin shokun Enver Hoxha, të cilët duhet t'i shkaktonin ndërlikime shëndetit të tij. Përkishtë për këtë u shpejtua nisja për në Paris... "Në fund të prillit të vitit 1981, tha kjo e pandehur, në Paris jam takuar me një person të zbulimit jugosllav, i cili më dha një pako me pílula helmi për t'ia dorëzuar Mehmet Shehut sa më shpejt". Këtë fakt e kon-

firmon edhe i pandehuri Skënder Shehu, i cili ka mësuar nga e pandehura Fiqirete Shehu se në takimin me agjentin jugosllav në Paris, jugosllavët kërkonin marrjen në dorë nga Mehmet Shehu sa më parë të udhëheqës së Partisë, duke likuiduar fizikisht udhëheqësin e saj me anë të helmit, të cilin ia dhanë kësaj agjenteje në Paris. "Ishte kjo arsyeja sqaron në hetuesi që në gjyq i pandehuri Skënder Shehu, që e bënte të domosdoshëm takimin edhe me personelin e agjunkturës amerikane në Suedi, ku do të vendosej për fundimisht". Pasi siguruan helmin me efekt të vonuar, pjesëtarët e organizatës kundërrevolucionare të kryesuar nga poliagjenti Mehmet Shehu, përgatitën planin e detajuar të veprës terroriste dhe pastaj të marrjes së pushtetit, duke ndarë rolet dhe detyrat në vartësi të funksionit që kryente secili. Të pandehurës Fiqirete Shehu u ngarkua detyra që gjatë pushimeve në Vlorë, kur Sekretari i parë i Komitetit Qendror të partisë të shkëmbente vizita me Mehmet Shehun të gjente momentin më të përshtatshëm për t'i hedhur në kafë helmin me efekt të vonuar, i pandehuri Llambi Ziqishti do të manipulonte rezultatit e analizave toksikologjike dhe të autopsisë mjeko-ligjore, kurse i pandehuri Nesti Nase do të gjente literaturë për format dhe metodat e atentateve kundër personaliteteve politike, të të shmagte daljen e sekreteve të kësaj veprimtarie kriminale jashtë shtetit dhe do të ndërpriste çdo informacion që mund t'i vinte Shqipërisë për veprimtarinë e zbulimeve të huaja kundër vendit tonë. Detyra të rëndësishme kanë pasur edhe anëtarët e tjerë të kësaj organizate. E pandehura Fiqirete Shehu për këtë problem shpjegoi: " ... Mehmeti bisedoi menjëherë me Kadri Hazbiun, Feçor Shehun, Llambi Peçinin dhe Mihallaq Ziqishtin e me mua ... Mehmet Shehu bisedoi edhe... me Llambi Ziqishtin ... dhe i dha porositë. ... Kadri Habiu tha që vrasjen me helm të sheqerosur ta bëjmë në Vlorë, kur sekretari i Parë i Komitetit Qendror të vinte për pushime ... T'i hidhim në kafë pilulën me helm që prura unë nga Parisi". Edhe i pandehuri Llambi Ziqishti shpjegoi: " ... në gusht të '81-it Mehmeti më thirrri dhe më tha: ... Likuidimin e udhëheqësit kryesor të partisë ... do ta bëj unë. Për këtë qëllim kam siguruar edhe mjetin, helmin me veprim të ngadaltshëm, të cilin e solla Fiqiretja nga jashtë ... Mehmeti më tha se rrugë tjetër nuk ka ... Kur të dukeshin shenjat e para të helmimit unë do të manipululoja analizat dhe më pas do të manipululoja autopsinë... Unë duhet të ruaja edhe analizat e manipuluar edhe kopjet e vërteta, që ai (Mehmet Shehu) ... do t'i

përdorte për të akuzuar kundërshtarët si vrasës". Ndërsa i pandehuri Nesti Nase për këtë problem shpjegoi: "Mehmet Shehu më tha ... ka ardhur koha që ndryshimet të bëhen me pahir, me anë të forcës dhe për këtë problem kam biseduar edhe me Feçorin edhe me Kadriun, të cilët janë ngarkuar se si do të vepronë... Ti Nesti duhet të mendosh për të vepruar menjëherë për të justifikuar ndryshimet që do të bëhen në udhëheqje dhe qëndrimet që do të mbajmë". Siç u vu në dukje për të dalë nga gjendja e rëndë që po kalonte Jugosllavia më 16 e 17 dhjetor 1981, UDB-ja nëpërmjet agjentëve të saj i transmetoi Mehmet Shehut që "Enver Hoxha të vritet me çdo kusht me armë zjarri, edhe në mbledhje gofite duke u vranë edhe ai vetë". Terroristi Mehmet Shehu u ndodh në rrugëkryq: nga njëra anë Byroja Politike e Komitetit Qendror të Partisë së Punës të Shqipërisë i kërkonte llogari për fejesën e djalit dhe për veprimet e tjera të tij antiparti, nga ana tjetër UDB-ja e urdhëronte për veprim. Pas konsultës me bashkëpunëtorët e tij më të ngushtë ashtu si dikur shoku i tij Nako Spiro vendosi dhe vrau veten, që të shpëronte të kaluarën e tij të lavdishme", llogari dhe fëmijët dhe që të mos jete llogari para Partisë e popullit për punët e poshttra armiqësore që kishte bërë tinëzish për 40 vjet rresht. Por në sajë të vigjilencës së saj Partia i zbuloi fijet e këtij komploti dhe e shpartalloi atë. Nga gjithë zhvillimi i hetimit dhe gjyqimit u vërtetua plotësisht se një nga drejtësit kryesore të kësaj organizate kundërrevolucionare të drejtuar nga tradhtarit Mehmet Shehu, ka qenë sabotimi i orientimeve dhe i direktivave të Partisë dhe i gjithë veprimtarisë në fushat e ndryshme të zhvillimit të jetës në vendin tonë. Këta armiq kanë përmbytur detyra të posaçme për të penguar e shtrembëruar zbatimin e vijës së Partisë dhe për të sabotuar ekonominë socialiste në sektorët që mbulonin. Kjo veprimtari sabotuese është në lidhje të ndërsjellë e koordinuar edhe në vazhdim të sabotimeve, që kanë bërë të frymëzuar nën drejtimin e mercenarit Mehmet Shehu, grupet e tjera antiparti, tradhtarë komploteuse puçiste e sabotuese në fusha të ndryshme të ndërimit socialist në vendin tonë.

Në emër të popullit

Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë të RPSSH, në trup gjyqësor nën kryesinë e: Arianit Çelës – Kryetarit i Gjykatës së Lartë, me sekretarë Ylli Mahmudja e Sadik Memo dhe me pjesëmarrjen e Prokurorit të Përgjithshëm, Rrapi Mino, prej datës 15 gjer më 29 Gusht 1983 gjykoj në shkallë të parë në seancë gjyqësore me detyrë të hapura çësht-

tjen penale nr. 7 akti, që u përket të pandehurve:

1. FIQIRETE SHEHU, e bija e Abedinit dhe e Hedijes lindur në vitin 1919 në qytetin e Beratit dhe banuese në Belsh të Elbasanit, me shtetësi e kombësi shqiptare, me origjinë shoqërore fshatare e pasur, me gjendje shoqërore nëpunëse ish-drejtoreshë e Shkollës së Lartë të Partisë "V.I. Lenin" në Tiranë, me arsim të lartë, nuk mbanë tituj nderi ose dekorata, e padënuar më parë, e arrestuar më 6 Janar 1982.
 2. LLAMBI ZIQISHTI, i biri i Petro dhe i Julies, lindur në vitin 1923 në Ziqisht të Korçës dhe banues në qytetin e Tiranës, me shtetësi e kombësi shqiptare, me origjinë shoqërore zanatçi individual dhe me gjendje shoqërore nëpunës, ish-ministër i Shëndetësisë) i martuar, ka dy fëmijë, i përjashtuar nga Partia, me arsim të lartë, nuk mbanë tituj nderi ose dekorata, i padënuar më parë, e arrestuar në datën 15 maj 1982.
 3. NESTI NASTE, i biri i Vancit dhe Olimbisë, lindur në vitin 1922 në qytetin e Korçës dhe banues në Tiranë, me shtetësi dhe kombësi shqiptare, me origjinë shoqërore qytetar i varfër, me gjendje shoqërore nëpunës ish-ministër i Punëve të Jashtme, i ve pa fëmijë, i përjashtuar nga Partia, me arsim të mesëm, nuk mban tituj nderi ose dekorata, i padënuar më parë, e arrestuar më 8 janar 1982.
 4. SKËNDER SHEHU, i biri Mehmetit dhe Fiqiretes, lindur më 1949 në qytetin e Tiranës dhe banues në Belsh të Elbasanit, me shtetësi e kombësi shqiptare, me origjinë e gjendje shoqërore nëpunës, i pa martuar, me arsim të lartë, nuk mbanë tituj nderi ose dekorata, e padënuar më parë, e arrestuar më 8 Janar 1982.
- TË AKUZUAR SE:
- I) Janë nënë në shërbim të agjunkturave të huaja dhe kanë kryer detyrat e ngarkuara prej tyre;
 - II) kanë marrë pjesë në organizata kundërrevolucionare të kryesuar nga tradhtarit dhe poliagjenti Mehmet Shehu, që ka pasur për synim të godasë PPSH, udhëheqjen Marksiste-Leniniste dhe të përmbysë pushtetin popullor në Shqipëri;
 - III) kanë kryer veprime përgatitore terrori për eliminimin fizik të Sekretarit të Parë të KQ;
 - IV) kanë sabotuar vijën politike dhe ekonomike të Partisë, duke i shkakton shtetii 1.219.763 lekë dëm material.
 - V) kanë zhvilluar agjitacion dhe propagandë kundër shtetit, d.m.th. se kanë kryer krimet e parashikuara përkatësisht nga nenet 47 germa "g", 57, 50 paragrafi I-rë në lidhje me nenin 11 paragrafi i parë 53 dhe 55 paragrafi i parë të Kodit Penal të RPSSH. Trupi gjyqësor, gjatë gjyqimit të çështjes, degjoi shpjegimet e secilit të pandehur, thëniet e shumë dëshmitarëve, administratori drejtpërdrejtë aktekspertizën, dokumente dhe prova të ndryshme materialo-shkencore, si dhe degjoi bisedimet e fundit, gjatë të cilave:
 - Prokurori kërkoi të deklarohen fajtorët të pandehurit për krimet që akuzohen dhe, në bazë të dispozitave ligjore që parashikojnë këto krimet, përfundimisht të dënohen:
 - E pandehura Fiqirete Shehu me 25 vjet heqje të lirisë
 - I pandehuri Llambi Ziqishti me vdekje
 - I pandehur Nesti Naste me 22 vjet heqje të lirisë
 - I pandehuri Skënder Shehu me 15 vjet heqje të lirisë
 - Kurse në fjalën e mbrojtjes, të katër pranuan fajësinë e tyre për krimet e akuzuara, deklaruan se janë penduar thellë dhe kërkuan dënim më të butë".

**GRAHMAT
E DREJTËSË**

Fajtorët të lirë dhe të pafajshmit prapa hekurave!

Ka nga ata që e kanë krahasuar me një rrjetë merimange, të tjerë me një fat keqësi publike, të tjerë akoma kanë pranuar se është e njëjtë për të gjithë – por vetëm nëse janë kriminelë. Sot, sondazhet thonë se në Pekin dhe në Moskë nuk kanë besuar asnjëherë tek ajo, por institucioni (mes fajtorëve në liri dhe të pafajshmëve prapa hekurave) ka pësuar të çara edhe në perëndim. E megjithatë, nuk mund të bëjmë pa drejtësinë. Një herë e një kohë thuhej se shpata e saj nuk kishte mill: kushdo mund të mbetej viktimë. Për shkrimtarin rus, Leon Tolstoi, ishte simbol i padrejtësisë, për shkrimtarin amerikan Henry Mencken ishte ndër gjërat më të vështira për t'u duruar. Ka nga ata që e kanë krahasuar me një rrjetë merimange, të tjerë me një fatkeqësi publike, të tjerë akoma kanë pranuar se është e njëjtë për të gjithë – por vetëm nëse janë kriminelë. Sot, sondazhet thonë se në Pekin dhe në Moskë nuk kanë besuar asnjëherë tek ajo, por institucioni (mes

divë, dhe për ta shmangur këtë, flijimi i agresorit dukej i pashmangshëm. Dënimi mund të jepej nga një individ i vetëm, por ekzekutimi në grup ishte edhe më efikas: vrasja me gurë enjë të dënuari (aplikohet edhe sot në shumë vende islamike) kompromentonte të gjithë, ishte antidoti i tundimit për të imituar fajtorin dhe u ofronte ndëshkuesve një mundësi që të kryenin më të drejtë një akt të krahasueshëm me atë që kishin pësuar.
Sy më sy
Një prej përmbledhjeve më të lashta të ligjeve të skalitura në gur është kodi i Hammurabit, i gjendur në Susa (Irani i sotëm) nga një ekip arkeologësh francezë. Hammurabi, mbreti i Babilonisë në vitin 1700 para Krishtit, bëri publikë 282 dënime, që shtriheshin nga krimet e kryer në hapësirën familjare, deri tek përgjegjësitë e ndërtesuesve të shtëpive, nga

jatja e debatit (zakonisht disa dhjetëra minuta) shënohej nga një gotë me ujë që zbrazej dhe magjistrati kufizohet të verifikonte që procedurat respektoheshin. Dënimi jepej nga një juri popullore që (për të shmangur përpjekjet për korruptim) duhej të shprehej në kohën më të shkurtër të mundshme. Për shekuj të tërë ishin shumë të paktë ligjet e shkruar: u desh të pritej përhapja e praktikave tregtare dhe lindja e një klase të re drejtuese që sistemi penal grek të kodifikohet (diku rreth shekullit V para Krishtit). Por ishte ende vetëm fillimi.
I barabartë për të gjithë
I pari aparat juridik koherent ishte ai i Dymbëdhjetë tryezave romane (451 para Krishtit) që futën rregullat e të drejtës publike dhe private dhe që shtytsën e morën pikërisht nga grekët. Tyezat vendosnin barazinë civile me princëve dhe plebejve dhe për

mirë, oratoria e të cilit ndiqej dhe duartrokitej nga qindra vetë. Për krime kundër shtetit (si tradhëtia e lartë) dënimi kapital ishte pothuajse i sigurtë.
E drejta romake, në periudhën republikane u zhvillua me hapa të mëdhenj (ligjet shkruheshin, por zbatimi i tyre ishte tjetër gjë) por u ndal menjëherë me ngjitjen e perandorisë, kur u vendos një sistem inkuizitor dhe, në krahasim me të kaluarën, koncepti i pranimit të fajësisë: nuk i takonte më akuzës të demonstronte përgjegjësinë e të akuzuarit, por i takonte të akuzuarit të vërtetonte pafajësinë e tij.
Inkuizitorë
Pas rënies së perandorisë romake

jonet transalpinë dhe në shtetin papnor inkuizicioni (i ushtruar nga gjykata eklesiastike apo civile) vazhdoi të paktën deri në fundin e vitit 700. "Ideja ishte që e keqja mund të fshihej kudo dhe, për të shmangur përhapjen, ajo duhej të çrrënjosej", vazhdon Camposi. "Mes dyshimit dhe fajësisë, vija ndarëse ishte shumë e lëvizshme dhe për të marrë rrëfimin e të akuzuarit çdo mjet konsiderohej i ligjshëm".
Me pretekstin e dënimit biblik (krimet ishin mëkate) u ekzekutoan jo vetëm keqbërës profesionistë, por edhe mijëra ciganë, të huaj dhe vagabondë: torturat kryeshin rregullisht dhe çonin pothuajse gjithmonë në rrëfimin edhe për krime inekzistentë dhe më pas dënimin, ndërkohë që mbrojtja nuk ishte veçse një gur pengues. Vetëm nëse i akuzuari u mbijetonte torturave të hetuesve do të demonstronte pafajësinë e tij. Diçka thuajse e pamundur.



dhe një periudhe anarkie juridike relative (deri me ardhjen e Charlemagne, në vitin 800 praktikat në përdorim ishin nga më të ndryshmet) u vendos gradualisht, në Itali dhe në Francë, Inkuizicioni i shenjtë. Ishte njësoj si të bije nga tigrani në prush.
"Peshkopët u ngarkuan me çrrënjosjen e mëkatit për të mbrojtur komunitetet e tyre", shpjegon Giuseppe Campos, studiuesi i Filozofisë dhe të drejtës në Universitetin e Barit. "E bënë edhe duke nisur guetinë e heretikëve dhe të shtrigave. Nuk kish nevojë që dikush të ngrinte një akuzë: autoriteti mund të vepronte në autonomi dhe fshehtësi të plotë, edhe pa dënimin e të akuzuarit".
Metodat, që ishte një projekt politik dhe fetar, u pa si një shans nga princërit dhe sovranë: bindja që shteti duhej të mbrohej me çdo mjet i bëri magistratët, që atëherë konsiderohehin si mbajtës të të vërtetave absolute, që të ndiqnin të akuzuar edhe në bazë të "zërave që qarkullonin": për të akuzuarin që vihej praktikisht para makinës së drejtësisë, ishin shumë të paktë shanset që t'i shpëtonte dënim-it. Kush kishte para mjaftueshëm mund të blinte pandëshkueshmërinë (por nuk kish asnjë garanci për kohëzgjatjen e saj) ndërkohë që për masat ndëshkimit u bënë gjithnjë e më të rëndë. Në Piemonte, në Toskanë, në ra-

torëve në liri dhe të pafajshmëve prapa hekurave) ka pësuar të çara edhe në perëndim. E megjithatë, nuk mund të bëjmë pa drejtësinë. Mbrojtje sociale
Penalisti Franco Cordero, në një prej librave të tij më të famshëm dhe të kritikuar, "Vëzhguesit" vëren se të jetosh në boshllëkun normativ, duke refuzuar rregullat dhe dënimet, është po aq e pamundur sa edhe të jetosh në boshllëkun atmosferik: sistemet penalë, nga Kaini e më vonë janë një kërkim i palodhur teknikash dhe strukturash për të mbajtur pushtetin dhe siguruar rendin. E drejtë apo e përmbledhur qoftë, drejtësia i ka rrënjët e veta në tabutë e popullsisve primitive. Dhunimi i trupit dhe pronës së anëtarëve të një klani nënkuptonte të ndizje zemërimin e perën-

vrasjet, deri tek grabitjet. Kodi parashikonte shpesh ligjin e talionit, sipas të cilit ndëshkimet duhet të korrespondojnë me dëmin e pësuar: vrasja ndëshkohej me vdekje, vrasja enjë të riu korrespondonte me ekzekutimin e djalit të vrasësit. Nëse krimi nuk ishte trupor, ndëshkimi jepej në bazë të shkeljes që ish bërë kundrejt shoqërisë (dhe shtresës së të akuzuarit). Ky ligj u aplikua edhe më vonë nga grekët dhe romakët, madje edhe nga disa komuna italiane deri në shekullin XVIII.
Proceset e parë
Ideja e një procesi publik lindi në Greqinë e lashtë. Një qytetar çfarëdo i Athinës mund të kërkonte që të niste një proces, si në rastin kur ishte viktimë e një krimi ashtu edhe kur ishte dëshmitar i një shkeljeje. I akuzuari nuk kish të drejtë për avokat, por mund të paraqiste, për mbrojtjen e tij, kujtime të shkruar nga profesionistë (që quheshin logografë). Kohëzgj-

herë të parë sanksiononin themelin e shtetit tek ligjet. Ciceroni (shekulli I para Krishtit) rrëfen që në kohën e fëmijërisë së tij të gjithë duhej t'i njihnin përmendësh Tyezat, por përdorimi i tyre u zbeh më vonë (origjinali i Kodit u dogj gjatë zjarrit të Romës në 390 para Krishtit). Sot, nga kodi i Tyezave kanë mbetur vetëm disa lajme fragmentarë: dokumenti disiplinonte proceset, ndalonte norma në favor apo kundër një qytetari dhe mbronte familjen; por parashikonte edhe që të sapolindurit me keqformim të hidheshin në det, miratonte vrasjen e një hajduti të kapur në flagrancë dhe djegien në turrën e druve të piromanëve. Gjatë proceseve romakë debutuan avoketërit, dëshmitarët dhe provat dokumentare dhe vendimi final u takonte pretorëve, magjistratëve dhe jurive të fisnikëve. Kishte raste kur bëhej edhe marrëveshje me palëve, por në shumicën e rasteve mbizotëronin hakmarrja private dhe korupsioni: prerja e kokës dhe prerjet e gjymtyrëve ishin në rend të ditës dhe, në mungesë të treguesve bindës, ai që fitonte ishte ai që mundej të kishte avokatin më të



kur banorët e një fshati kapnin një të dyshuar për herezi dhe e çonin përpara zotërisë vendas, si do të kish qenë i mundur një gjykim? Si do të kish mundur një laik anal-



E vërteta e frikshme e shkencës së ekzekutimeve me vdekje

Një numër ekzekutimesh me vdekje, të dhëna kohët e fundit në ShBA kanë rikthyer debatin mbi injektimin vdekjeprurës dhe natyrën antinjerezore të tij, krahasuar me metoda të tjera të përdorura për të burgosurit e dënuar me vdekje. Në janar, kur shteti i Ohajos përdori një "koktejl" të ri drogërash për të ekzekutuar përdhunuesin dhe vrasësin e dënuar, Dennis McGuire, ai u përpilët në mënyrë të përsëritur dhe iu deshën më tepër se 25 minuta për të vdekur. Ditë më parë, Oklahoma ekzekutoi Michael Lee Wilson, vrasësin e dënuar me vdekje, fjalët e fundit të të cilit ishin: "E ndiej gjithë trupin të më digjet."

Po ta lëmë mënjanë çështjen nëse dënimi me vdekje në vetvete është antinjerezor, dikush mund të mendojë se shkencën mund të përdoret për të ndihmuar në shpikjen e një metode ekzekutimi që e kursen të dënuarin nga vuajtja e gjilpërave. Ka shumë shembuj historikë shkencëtarësh të cilët kanë ofruar ekspertizën e tyre në ekzekutime. Në fund të

shekullit të 19-të, kërkuesit në Shtetet e Bashkuara krijuan karigen elektrike si një alternativë më njerëzore ndaj varjeve publike. Pavarësisht përpjekjeve, ekzekutimet duke përdorur karigen ishin groteske. "Kokërdhokët e syve të të dënuarit ndonjëherë dilnin dhe qëndroni mbi faqet e tij. Shpesh, ai urinonte, defekonte dhe villoje gjak. Trupi bëhej i kuq me rritjen e temperaturës dhe lëkura e tij rrudhosej. Ndonjëherë i burgosuri mbulohej nga flakët."

Ekspertët mbajnë distancë

Një shekull më parë, dy mjekë francezë kishin krijuar gjyotinën, e cila do të ishte një makinë jo e dhimbshme dhe efciente për ekzekutim. Sot, mjekët udhëhiqen nga betimi i Hipokratit, i cili i ndalon ata të marrin pjesë nga dëmtimi i qëllimshëm i të tjerëve. Kur injeksioni vdekjeprurës erdhi në jetë, në vitin 1977, komuniteti mjekësor ruajti distancën. Një profesor i drejtësisë në Universitetin Fordham që ka marrë pjesë në testimin e rasteve me injeksion vdekjeprurës thotë se ndë-

rhyrja në protokollin e tre drogërave përdorte injektimin. Ai shton se nuk bëhej ndonjë testim mjekësor për kombinimin e drogërave, se nuk kishte ndonjë shkencë pas kësaj. Tani, në disa vende, sasia e pakët e drogërave kritike i kanë nxitur departamentet të gjejnë alternativa të reja të patestuara ende. Megjithatë shkencën mund të ndihmojnë në zhvillimin e një metode më njerëzore të vrasjes, ata me ekspertizën e përshatshme mund të mos përfshihen. Metodat e ekzekutimit të përdorura në periudha të ndryshme historike

Injeksioni vdekjeprurës

Deri në vitin 2010, shumica e vendeve përdornin kombinimin e tre drogërave: një anestetik, një agjent paralizant për të paralizuar sistemin muskolor dhe një drogë për të ndaluar punën e zemrës. Së fundmi, kompanitë farmaceutike evropiane kanë refuzuar shitjen e drogërave për injektim vdekjeprurës në ShBA, duke u kërkuar shteteve të gjejnë alternativa të reja të papërdorura.

Dhoma e gazit

Dhomat e gazit u përdorën për

herë të parë në ShBA në vitin 1924. Në këtë procedurë, një njeri lidhet brenda dhomës, e cila më pas mbushet me gaz toksik hidrogjen cianid. Mungesa e oksigjenit shpie direkt në vdekje, por i dënuari nuk e humbet ndërgjegjen menjëherë.

Karrigia elektrike

Karrigia e parë elektrike u përdor në vitin 1890. Elektrodat e lidhura në trupin e të dënuarit përcjellin rrymë elektrike.

Varja

Varja përdorej si një metodë primare e ekzekutimit në ShBA, deri në shpikjen e karrigës elektrike. Vdekja shkaktohet në mënyrë tipike nga shkëputja e vertebrale ose asfiksioni, por në rastet kur litari është shumë i gjatë, të dënuarit mund t'i pritët koka. Nëse është shumë e shkurtër, atij i duhen më tepër se 45 minuta për të vdekur.

Toga e zjarrit

Kjo metodë ekzekutimi e stilit të vjetër të Perëndimit daton që prej kohës kur u shpikën armët e zjarrit. Në një skenar tipik në ShBA, i dënuari lidhet në një kar-

rige. 5 njerëz me maska, anonimë, qëndrojnë 6 metra larg dhe drejtojnë pushkën në drejtim të zemrës dhe qëllojnë.

Gijotina

E shpikur në Francë në fund të shekullit 18 gjatë Revolucionit Francez, gijotina u krijua si një mënyrë praktike ekzekutimi. Ajo e priste kokën më shpejt dhe më me efektivitet sesa një shpatë.

Kryqëzimi

Kjo metodë daton në shekullin e 6-të para Krishtit, e cila përdoret ende në shtetin e Sudanit. Një person lidhet dhe gozdhohet në kryq dhe pret për t'u varur. Vdekja është e ngadalhtë dhe e dhimbshme dhe zgjat disa orë deri në disa ditë.

Gjuajtja me gurë

Kjo metodë antike e ekzekutimit vazhdon të jetë një dënim për tradhëtinë bashkëshortore edhe sot.

Shtypja nga një elefant

Kjo ishte e zakonshme për shumë shekuj në Azinë e Jugut dhe juglindore. Një elefant do ta shtypte dhe shqyente të dënuarin për tradhti.

/gazetaexpress.com/

fabet të përcaktonte kredencat e të akuzuarit si heretike ose jo? Dhe në çfarë mënyre dëshmitarët do të dëgjoreshin dhe vlerësoheshin? Inkuizicioni mesjetar daton nga viti 1184, vit në të cilin Papa Lucii i III-të u dërgoi një listë herezish peshkopëve të Evropës dhe i urdhëroi ata që të merrnin një rol aktiv në përcaktimin e faktit nëse të akuzuarit për herezi qenë praktikisht fajtorë. Më shumë se të mbështeteshin mbi gjykatë shekullore, zotërinj vendas apo deri të rrezikonin lançime nga egërsia popullore, peshkopët qenë ftuar të verifikonin akuzat për herezi në vetë diqozat e tyre, nëpërmjet shqyrtimit të ekleziastëve kompetentë që të dinin të përdornin të drejtën romake. Me fjalët të tjera, që të dinin të kryenin një "hetim" (nga këtu termi "inkuizicion"). Nga perspektiva e autoritetit shekullar, heretikët qenë tradhtarë të Zotit e të Mbretit dhe, për pasojë, meritonin vdekjen. Kurse nga perspektiva e Kishës, heretikët qenë dele të hutuara, të larguara nga grigja. Si barinj, Papa dhe peshkopët kishin detyrimin që t'i çonin këto dele në vathë, ashtu si Bariu i Mirë i kish urdhëruar ata. Kështu, atje ku sovranët tentonin të ruanin

mbretëritë e tyre, Kisha kërkonte që të shpëtonte shpirtin. Inkuizicioni u ofroi heretikëve një rrugëdalje për të shmangur vdekjen dhe për t'u kthyer në komunitet. Pjesa më e madhe e të akuzuarve për herezi nga Inkuizicioni mesjetar u çlirua nga akuzat, dhe vendimi i tyre u pezullua. Atyre të gjetur fajtorë për gabime të rënda iu lejua që ta rrëfenin mëkatin e tyre, të pendoheshin dhe të rifuteshin në Trupin e Krishtit. Me futjen e françeskanëve dhe të dominikanëve, në fillimet e shekullit të XIII-të, i dha papatit një trup fetar të kushtuar, që i drejtoi jetët e komponentëve të tij nga shpëtimi i botës. Pasi urdhri i tyre ishte krijuar në mënyrë të shprehur për të luftuar heretikët dhe predikuar fenë katolike, dominikanët u bënë veçanërisht aktivë në Inkuizicion. Në përputhje me ligjin më progresist të kohës Kisha në shekullin e XIII-të ngriti gjykata hetimore të varura nga Roma më shumë sesa nga peshkopët vendas. Për të garantuar respektimin e të drejtave dhe uniformitetin e trajtimit, u shkruan manualë për inkuizitorët. Bernardo Gui, sot i njohur më mirë si inkuizitori fanatik dhe mizor i romanit "Emri i trëndafilut", shkroi

një manual shumë influencues për epokën. Nuk ka asnjë arsye për të besuar se Gui ishte disi i ngjashëm me portretin e romanizuar të tij. Nga shekulli i XIV-të, Inkuizicioni mundi të gëzonte kompetencën më të mira ligjore të disponueshme mbi sheshin. Zyrtarët e Inkuizicionit qenë të diplomuar dhe të specializuar në drejtësi dhe teologji. Pershtatru ne shqip nga bota al

Nën akuzë

Në zonat veriore të Europës (Anglia në krye, ku Kisha nuk ishte e pushtetshme si në Spanjë, Francë apo Itali) u zhvillua një sistem penal i ndryshëm, i quajtur akuzator. Kur denoncohej një krim, të akuzuarit i jepej mundësia të mbrohej përpara një jurie popullore. "Procesi merrte formën e një sfide", tregon Campesi. "Dhe debati zgjidhej përmes mekanizmeve irracionale të provës: duela, marrëveshje, apo dëshmi me betim. Në rastin e parë, debati zgjidhej me forcë. Në të dytin përmes rritualeve magjike, si për shembull të ecurit mbi gymyr të ndezur (kush rezistonte kishte mbështetjen e perëndive dhe e fitonte çështjen). Në të tretin mbështeteshin në reputacionin social të palëve: kush kish më

shumë mbështetje, kishte dhe të drejtë ndaj tjetrit".

Pas shekullit XIII mbizotëroi buon sensi dhe proceset, në sistemin akuzator nisën të bazonin më përplasjen dialektike, mes të akuzuarit dhe akuzuesit, si dhe mbi aftësinë për të prodhuar prova. "Edhe në këtë rast nuk mund të ishte i sigurtë që do të mbërrihej në një të vërtetë absolute, më shumë pritej një e vërtetë formale", saktëson Campesi. "Dicka e ngjashme ndodh edhe sot në sistemin gjyqësor amerikan, ku aftësia për të bindur jurinë përbën një element qendror".

Parandalimi

Megjithatë, ishin Iluminizmi dhe drejta napoleonike (me idetë e tyre të barazisë sociale dhe të drejtave njerëzore) që hodhën bazat për sistemet penale moderne, mes shekujve XVIII dhe XIX. Për herë të parë burgosja u klasifikua si një dënim dhe jo si parandomë e ndëshkimit. Filozofë si Zhan Zhak Ruso në Francë dhe Cezare Bekaria në Itali folën për domosdoshmërinë e një shteti moral, si dhe heqjen e torturës dhe dënimit me vdekje. Për Bekarian, e rëndësishme ishte të parandaloheshin krimet, të garantoheshin një mbrojtje e barabartë për të gjithë

si dhe të futeshin dënime që të ishin në gjendje të riedukonin të dënuarit, dhe jo vetëm nga ata që shkatërronin fizikun dhe psikikun.

Burgimet e përjetshme dhe varjet në litar nuk do të kishin asnjë efekt frenues mbi komunitetin. "Sistemi penal që doli nga kjo, pas një debati të ashpër, ishte një sistem i përzierë, me një fazë të parë inkuizitore (ku hetimet i kryente gjykatësi instruktur) dhe një fazë të dytë akuzatore, ku shkohej në proces dhe mbrojtja vihej në dije-ni për akuzat", shpjegon Campesi. "Mekanizmi ishte ende i paekuilibruar në favor të akuzës, që në fazën e parë mund të vepron-te në fshetësi, por ishte bërë gjithësesi një hap i madh përpara."

Garantizimi

Ky sistem ka karakterizuar shumë vende evropiane deri në dekadat e kaluara: në Itali, në vitin 1988 u hoq gjykatësi instruktur dhe u futën figurat e ministrisë publike dhe gjykatësit për hetimet paraprake. Mekanizmi u bë kështu tërësisht akuzator, apo më garantist. Sigurisht, peshorja e përsosur ende nuk është shpikur, por akuzat dhe mbrojtja sot janë në gjendje të luajnë me letra të hapura. /Focus/

Anti CORRUPTION



PUBLICATION OF ASSOCIATION OF ALBANIAN ADVOCATES OF ANTI-CORRUPTION

Biweekly, Informative, Denouncing and Investigative Magazine First Year of Publication, Number 1, July 14, 2014 Price: 200 L 0.5 euro
Address: St. Ibrahim Rrugova, Complex: Green Park, Building no.26, Mobile: +355 692020512 /612 www.antikorrupsion.com

Corruption in the Judiciary! Agim Bendo, Most Corrupt Judge of 20 years, ready prison blankets



editorial

Amnesty for Cannabis Sativa

All are equal before the law, such as Lazarati of Gjirokastra and Shkodra, as well all light drug users, who have filled up the prisons...

By Av. Ndue Pjetra

In the present day, there is a huge number of arrests in our country for the offense of Production, Trafficking, Cultivation and Sales of Narcotics. Almost all courts are in dilemma and therefore the question arises for the judges, how to act in terms of penalties. Regardless of punishment measures provided in the Criminal Code, according to recent events, the punishment are not issued to all Albanians alike. Otherwise the sentences do not predict the type and quantity of the drug in terms of punishment but is the same as for Cannabis Sativa (hashish) and other drugs such as cocaine or heroin. Currently, in Tirana Court of First Instance are adjudicated many persons, who are sentenced for the use of 3, 10, or 25 grams of light drugs, and their sentences define a minimum of 5 years imprisonment... Pg.6

Justice

Why is established the Association of the Albanian Advocates of Anticorruption.

Pg. 4

Investigation

Banks Thieves, how do they grab citizens' pockets

Pg. 5

Denunciation

Charges against Agency for Property Restitution and Compensation, abusing with Albanians properties

Pg. 6

Publications

Advocate, man of the law who represents and defends the right

Pg. 8

Proposal

Law Amendments to damage compensation

Pg. 9